

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7312 E mërkurë 4 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga MONIKA SHOSHORI STAFA

Gjatë marsit të këtij viti e deri në Gorët e fundit të një të diele shtatori, Martin Schulz, lideri socialdemokrat rrëfeu në një bashkëbisedim me gazetarët ...

Vijon në faqen 20

Berlin, "post-truth politics" i një beteje elektorale



Opinion

Ditës

Nga ALJULA JUBANI

Dikur, At Gjergj Fishta shkruante se në çështje të arsimit, të gjithë: popull, qeveri e parlament kanë qenë të një mendjeje dhe një zëri. Por qysh ...

Vijon në faqen 21

Egocentrizmi dhe akreditimi i Universitetit të Tiranës



Raporti i MB: Marjel Fierza është "ushtar" i Lul Berishës

I gjenden 2 armë në makinë, pranga pjesëtarit të bandës së Durrësit

U shpëtoi 3 atentateve në vitet 2010-2012, arrestohet edhe shoku i tij, Genti Nderjaku

Nga AGRON LISI

Deklaratat e ambasadorit amerikan Donald Lu kanë vënë në lëvizje policinë e Durrësit. Dy persona, pjesë e një bande kriminale, u arrestuan dhe nga blutë e qytetit bregdetar. Mësohet se në njëri nga ...

Në faqen 7

AFATI DERI ME 7 NENTOR, SA SHANSE KANE SHQIPTARET PER T'U PERZGJEDHUR

LOTARIA, UDHEZIMI I SHBA: SI TE APLIKONI

Udhëzimi i Ambasadës Amerikane për shqiptarët që duan të jenë pjesë. Kategoritë që favorizohen në përzgjedhje e pjesët ku duhet të kini kujdes



(Në foto) Lotaria Amerikane (foto ilustruese)

Në faqen 10-11

"VIP PAGES"



Xhensila Pere: Meshkujt bëjnë detyrën, së shpejti vij 'ho'

Suplement

Statusi i pronës në qarkun më të madh të veriut. Kronologjia e çdo toke

Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar

Sipërfaqja e pretenduar dhe sa ka marrë çdo familje

Nga ORNELA MANJANI

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe prob-



lematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban ...

Në faqen 17-19

RINGRITJA E PARTISE

Kritikët e Bashës me platformë të re: Zgjedhje brenda 9 muajsh

Në faqen 4

HISTORIA E KASEMIT

Arrestohet pas 2 vitesh në Itali "ish-ushtari" i Altin Dardhës

Në faqen 6

KUOTAT E PAPLOTESUARA

Ndryshon udhëzimi i MAS për regjistrimin në universitet, shtyhen afatet

Në faqen 9

FESTA E BASHKIMIT

Meta: Jo vetëm Gjermania, por edhe Shqipëria i përket Europës

Në faqen 2

INTEGRIMI REAGIMET

Ministria e Sigurisë u përgjigjet deputetëve të CDA

Rikthimi i vizave, Holanda: Nuk i heqim, incidentet me shqiptarët të ulëta

Holanda nuk mund të rikthejë vizat në mënyrë të njëanshme për Shqipërinë. Kjo, për arsye subjektive, pasi kriminaliteti shqiptar, megjithëse në vëmendje të autoriteteve, nuk është aq i lartë sa përfitet, por edhe për arsye objektive, pasi vendimi i përket Komisionit Europian. Debatit gati njëmuajor mes Amsterdimit dhe Tiranës ka marrë përgjigje përfundimtare nga Ministria holandeze e Sigurisë dhe Drejtësisë, e cila u është përgjigjur 12 pyetjeve të dorëzuara nga deputetët e "CDA"-së mbi kriminalitetin shqiptar, bën të ditur "TCH". "Nëse ka një njoftim të tillë nga një vend anëtar, është Komisioni Europian ai që humton, e si pasojë merr



vendim të zbatojë apo jo pezullimin e regjimit pa vizë. Komisioni Europian e vlerëson problemin e konstatuar

sipas interesave të BE-së. Nga vendet anëtare kërkohet miratimi i tyre. Nëse pas një periudhe 9-mujore nuk ka përmirësime, mund të ndodhë pezullimi nëpërmjet një akti që i delegohet Komisionit Europian. Si Këshilli, ashtu edhe Parlamenti Europian mund të kundërshtojnë veprimin e deleguar të Komisionit Europian". Po ashtu, përgjigjet e Ministrisë së Sigurisë dhe Drejtësisë relativizojnë e zbehin akuzat për një numër të madh krimesh nga shqiptarët. "Numri i inci-

denteve me persona të nacionalitetit shqiptar është në shifra absolute relativisht i ulët. Brenda kësaj, vlen të thuhet se numri i krimeve të një karakteri të organizuar është relativisht i lartë. Problematika përqendrohet në Amsterdam dhe Rotterdam. Këto aktivite lidhen me trafikun e drogës, si dhe problematikën e shqiptarëve që futen në kontenerët e 'Hoek van Holland' dhe në të tjera zona portuale".



Presidenti Ilir Meta dje, në festën e bashkimit të Gjermanisë

Presidenti në festën e bashkimit kujton vërshimin e shqiptarëve në dyert e ambasadës

Darina Tanushi

Presidenti Ilir Meta kujtoi dje, në festën e bashkimit të Gjermanisë, ditët kur shqiptarët u dyndën në Ambasadën Gjermane për një jetë më të mirë. Gjatë fjalës përshëndetëse që ai mbajti në pranë edhe të ambasadores Susanne Schütz, presidenti u shpreh: "3 tetori i vitit 1990 ishte dita e një mundësie të re jo vetëm për Gjermaninë, por për mbarë Evropën, për të jetuar në paqe dhe demokraci, në një projekt që transformoi historinë politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë kontinentit. Ndaj festa juaj kombëtare, në mënyrë unike, nuk është vetëm e juaja". "Dita e Bashkimit Gjerman është festë e të gjithë Evropës, dhe veçanërisht e atyre evropianëve që jetuan nën hijen dhe peshën e rëndë të Perdes së Hekurt. Ne ndajmë të njëjtin emocion dhe krenari me ju për çeljen e një epoke të re, pasi jetuam historinë, që siç do të thoshte Willy Brandt: 'Berlini jetoi që ta shihte murin të shembje'. Muri që u shemb në Berlin ribashkoi jo vetëm Gjermaninë, por njëkohësisht edhe nxitë ëndrrat e të gjithë kontinentit për të jetuar në paqe, liri dhe demokraci. Për ne shqiptarët, Dita e Bashkimit Gjerman është pikënisja e projektit më frymëzues, që do të bëhej një ortek i pandalshëm kuraje, optimizmi dhe shprese i bashkimit tonë me Evropën", - u shpreh presidenti. Sipas

Meta: Jo vetëm Gjermania, por edhe Shqipëria i përket Evropës

Ambasadorja Schutz: Vetingu, siguri për sipërmarrjet gjermane



Presidenti Ilir Meta me ambasadorën Susanne Schütz

tij, "Gjermania që ndër të parat vende ku qytetarët shqiptarë trokitën, edhe pse në atë kohë në mënyrë të paligjshme, në përpjekjen e tyre për të jetuar të lirë. Pamjet e vërshimit drejt Ambasadës Gjermane janë ende të freskëta në kujtesën e shumëkujt prezent këtu. Kjo ishte më shumë se shembja e Murit për ne. Ishte hapja e dyerve drejt lirisë dhe mundësisë për një jetë të re. Gjermania ishte dhe mbetet, pa dyshim, motori që i

dha jetë dhe mban në lëvizje projektin evropian". "Dëshiroj t'ju falënderoj veçanërisht për mbështetjen tuaj ndaj reformës në drejtësi, e cila do të forcojë sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar, dhe do të krijojë njëkohësisht një klimë më të favorshme e më të besueshme për tërheqjen e investimeve të huaja në vendin tonë", - u shpreh Meta. "Në këtë Ditë të Bashkimit Gjerman, mesazhi im për ju është, se jo

vetëm Gjermania, por edhe Shqipëria i përket Evropës, dhe jam i bindur se do ta përshkojmë këtë rrugë deri në fund së bashku", - theksoi Presidenti. Ndërkohë, ambasadorja Susanne Schutz deklaroi se sipërmarrjet gjermane kërkojnë siguri për investimet e tyre dhe nisja e vetingut është rruga e duhur. "Për sipërmarrjet gjermane janë më rëndësi siguria ligjore dhe besimi të institucionet. Gëzohem se, me nisjen e zbatimit të pro-

cesit të vetingut, Shqipëria është duke lëvizur në drejtimin e duhur", - deklaroi ambasadorja gjermane në Shqipëri, Susanne Schutz.

VIZITA

Më herët dje, Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti në një takim të veçantë ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Evropës së Dukatit të Madh të Luksemburgut, Jean Asselborn, i cili ndodhet në një vizitë zyrtare në Shqipëri. Presidenti Meta u ndal te çështjet e sigurisë dhe të luftës kundër terrorizmit e krimin të organizuar, si dhe shprehu besimin se Bashkimi Evropian do të vijojë me një strategji gjithëpërfshirëse integruese për të gjitha vendet e rajonit. Ministri Asselborn e siguroi Presidentin Meta për vijimin e mbështetjes nga Luksemburgu të procesit të zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe për ndihmën e drejtpërdrejtë që do t'i ofrojë Shqipërisë në kuadrin e përgatitjeve për negociatat e aderimit.



Asselborn: 2018-ta, vit shumë i mirë për hapjen e negociatave

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje, ministrin e Punëve të Jashtme të Dukatit të Madh të Luksemburgut, Jean Asselborn, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në vendin tonë. Ruçi vuri në dukje vendimarrjen parlamentare për ngritjen e organeve të rivlerësimit kalimtar të gjykatërëve dhe prokurorëve, si dhe të strukturave dhe të organikës të tyre, duke konkretizuar kështu procesin e reformës në drejtësi. Kryetari i Kuvendit bëri me dije se "kjo legjislaturë do të ndërmarrë reforma të një rëndësie të veçantë për vendin, duke filluar nga reforma zgjedhore". Nga ana e tij, ministri i Punëve të Jashtme të Dukatit të Madh të Luksemburgut, Jean Asselborn tha: "Unë shpreh bindjen se brenda vitit 2018 do të çelen negociatat me Bashkimin Evropian". Asselborn u prit dje edhe nga ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Gjatë deklaratës së përbashkët, ai u shpreh: "Viti 2018 mund të jetë një vit shumë i mirë për hapjen e negociatave. Mundësitë janë të mëdha dhe Luksemburgu do të vijojë ta mbështesë atë në këtë proces", - tha Ministri Asselborn.



Ministria e Mbrojtjes pret homologun polak: 400 mln lekë shtesë për ushtrinë

Xhaçka: Vendosim radarin e vëzhgimit të hapësirës ajrore, bashkëpunim me SHBA

"Shqipëria, qendër ekselence për studimin e luftëtarëve terroristë"

Darina Tanushi

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka bëri të ditur dje, se në bashkëpunim me SHBA-të është miratuar vendosja e radarit të vëzhgimit të hapësirës ajrore të Shqipërisë. Deklarata e ministres së Mbrojtjes vjen pas publikimit të skandalit me mosfunksionimin e radarëve, por edhe denoncimeve të fundit edhe nga aktorë të politikës. Këtë sqarim Xhaçka e bëri, gjatë një konference të përbashkët me homologun e saj polak Antoni Macierewic. Ministria Xhaçka e njohu homologun polak edhe me vendimin e fundit të Kuvendit, miratimin e aktivitetit normativ, i cili mes të tjerash ligjëron shtesën në buxhetin e shtetit për vitin 2017. "E njoha gjithashtu kolegun Macierewic për shtesën në buxhetin e mbrojtjes për vitin 2017 dhe trendin pozitiv të dakordësuar deri në vitin 2024. Katërqind milionë lekë të reja do të bëjnë të mundur që ne të kemi një rritje të rëndësishme të buxhetit të mbrojtjes, duke arritur nivelin e 1.15 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Këto para do të shkojnë për modernizimin e Forcave të Armatosura, duke përmbyshur objektivat e kapaciteteve të NATO-s për mbrojtjen e përbashkët ajrore", - tha dje, Xhaçka.



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka me homologun polak, Antoni Macierewic

BUXHETI

"Katërqind milionë lekë të reja do të bëjnë të mundur që ne të kemi një rritje të rëndësishme të buxhetit të mbrojtjes, duke arritur nivelin e 1.15 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Këto para do të shkojnë për modernizimin e Forcave të Armatosura, duke përmbyshur objektivat e kapaciteteve të NATO-s për mbrojtjen e përbashkët ajrore", - tha dje, Xhaçka.



Ligji për minoritetet përplas ministrin e Jashtëm me pakicën

OMONIA: Ligji na heq të drejtat. Bushati: Nuk ka të privilegjuar

Ligji "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" përballi dje, ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati me përfaqësues të këtyre pakicave. Palët ishin ftuar dje, në seancën dëgjimore në Kuvend. "Me këtë ligj shuhet pozita e privilegjuar e secilës prej pakicave në raport me tjetrën dhe fshihet dallimi që ka ekzistuar deri më sot", - tha ministri Bushati. "Do ta quaja fatale, nëse ky ligj do të shkonte nesër ose pasnesër për votim në parlament. Është një ligj që nuk i shton asgjë konventës-kuadër, por i heq, duke ia kaluar kompetencat Këshillit të Ministrave. Heq edhe shumë të drejta që ne i kishim nga konventa-kuadër e Këshillit të Europës", - tha Leonidha Papa, kryetar i shoqatës OMONIA. OMONIA kërkoi atë që është kërkuar në Maqedoni: dygjuhësinë në njësitë administrative, ku një e treta e popullsisë i përket minoritetit. Ndërkohë, përfaqësuesi i shoqatës maqedonase "Sonte" kërkoi minoritet në Shqipëri. "Në Shqipëri nuk ekziston minoriteti bullgar. Ky është një deformim i historisë dhe i së vërtetës. Në Prespë, Gorë e Gollbordë, ku pretendohet që ka minoritet bullgar, jeton vetëm minoritet maqedonas. Kjo kërkesë e Bullgarisë ka të bëjë me projektin e saj për "Bullgarinë e Madhe", - tha Vasil Sterjoski, nga shoqata maqedonase "Sonte". "Nga viti 1945, kur është bërë censusi për herë të parë, e deri në vitin 2011, që është censusi i fundit, nuk ka pakica të tjera të listuara përveç pakicave që listohen në këtë ligj", - tha Ditmir Bushati, në përgjigje. Por sërish, përfaqësuesit e shoqatave bullgare kërkuan njohjen e këtij minoriteti. "Ne si shtet nuk kemi preferuar që të hyjmë në çështje identitare, që në fakt nuk janë çështje tonat, por është një 'teatër' që luhet mes shteteve të tjera", - tha Bushati.

Ish-presidenti kundër emrave të Magjistraturës, Panda e Ibrahim

Reforma në drejtësi, Nishani: Po degradon, opozita të koordinohet

Ish-presidenti i vendit, Bujar Nishani deklaroi dje, se reforma në drejtësi po rrezikon degradimin. Në një analizë të tij, publikuar në rrjetin social "Facebook", Nishani u shpreh kundër emrave të propozuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe drejtuesit e institucioneve të tjera arsimore, Ilir Pandës dhe Genti Ibrahimit. "I pari, ish-ministër i Drejtësisë në qeverisjen socialiste dhe më pas N/kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (2003-2007), një nga periudhat e politizimit ekstrem të gjyqësorit shqiptar. I dyti, kryeautor i hartimit dhe mbrojtjes publike të projektit skandaloz të ndërtimit të institucioneve të vetingut dhe emërimeve në sistemin e drejtësisë që u denoncua si politik dhe u hodh poshtë në 70% të tij nga Komisioni i Venecias", komentoi dje, Nishani. "Kjo sjellje militanteske e Shkollës së Magjistraturës



dhe atyre drejtuesve të institucioneve që mazhoranca parlamentare caktoi si vendimmarrës për këtë proces delikat ishte në rrjedhën e logjikës që ndoqi vetë tentativa për kapjen politike të sistemit". "Fakti i të qenit ministër socialist i të parit apo hartues i një projekti të mbrapshtë për t'i shërbyer partisë nga i dyti, nuk i bën ata njerëz të këqij. Aspak. Por krejtësisht të pabesueshëm për të menaxhuar një proces

të pandikuar nga politika", tha Nishani. "Nëse me forcën e faktit të kryer të gurit dhe arrës në të njëjtën dorë do lejohet finalizimi i këtij synimi të kahershëm politik, do thyhjet për të mos u ngjitur dot më fija e kristalë e shpresës së mbetur te shqiptarët. Taksapaguesit miq e bujarë evropianë e amerikanë do duhet të jepnin përsëri e përsëri para, pasi proceset e vetingut dhe rivlerësimit do përsëriteshin çdo pesë vjet në vijimësi. Ata politikanë që mendojnë se procesin e reformës do ta përdorin si vathë për të mblodhur prokurorë e gjyqtarë të korruptuar e të kapur për t'i përdorur në interesin politik në dhunim të së drejtës dhe ligjshmërisë, kanë bërë një kalkullim fatal", - u shpreh Nishani. Ai i bën thirrje opozitës që të bashkërendojë veprimet, pasi ky do të ishte mekanizmi më efikas i garantimit të drejtësisë në reformën e drejtësisë.

tarëve të Huaj Terroristë", - deklaroi ministria gjatë deklararës së përbashkët për shtyp. Ministri Macierewic shprehu gatishmërinë e qeverisë polake për të emëruar sa më parë, atashëun ushtarak të Polonisë në Tiranë si dhe asistencën polake në funksionimin e Qendrës së Ekselencës për studimin e fenomenit të Luftëtarëve të Huaj Terroristë, që do të ngrihet në Tiranë. "Vendosëm që të forcojmë bashkëpunimin mes nesh, bashkëpunim i cili

mund të sjellë rezultate shumë të prekshme për sigurinë europiane. Ndaj, në këtë kontekst ne do të mbështesim ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Ekselencës, pranë së cilës do të kemi një prej ekspertëve tanë", - tha ministri Macierewic. Ministri polak deklaroi me medaljen "Yjet e Afganistanit" dy nënkolonelë shqiptarë. N/Kolonel Silvana Lahi dhe N/Kolonel Dritan Muka u dekoruan nga presidenti polak për per-

sonelin e huaj ushtarak, që i atashohet personelit polak në misionë jashtë vendit. N/Kolonel Silvana Lahi ka shërbyer pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Afganistanit si Këshilltarë për Operacionet Speciale. N/Kolonel Dritan Muka ka shërbyer në Shtabin e Operacioneve Speciale në Afganistan. Duke shfrytëzuar legjislacionin e brendshëm të Republikës së Polonisë, eprorët dhe kolegët e tyre polakë në mision kanë propozuar dekorimin.

Lëvizja për ringritjen e partisë, mungojnë firmat e Topallit, Rulit e Imamit

Kritikët e Bashës paraqesin platformën: Zgjedhje të reja në PD brenda 9 muajsh

"Pas humbjes, kryetari i PD të largohet, raportet me kundërshtarin sipas statutit"

Kritikët e kreut të PD-së, Lulzim Basha shpallën dje, platformën e Lëvizjes për Ringritjen e Partisë Demokratike. Në dokumentin prej disa faqesh, produkt i takimit që ata patën dje pasdite, kanë hedhur firmat Besnik Mustafaj, Majlinda Bregu, Astrit Patozi, Ridvan Bode, por nuk shihen Jozefina Topalli, Eduard Selami, Genc Ruli dhe Arben Imami. "Partia Demokratike gjendet sot në një situatë kritike për shkak të drejtimt të gabuar. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha është përgjegjësi kryesor për gjendjen, për rezultatit e saj katastrofik në zgjedhjet e 25 qershorit dhe për goditjen e qëllimshme të elementëve më bazikë të bashkëjetesës dhe të ekuilibrave të domosdoshëm të forcës sonë politike. Ai është, gjithashtu, autori kryesor i farsës së zgjedhjeve të 22 korrikut, të cilat e rënduan

edhe më shumë krizën e besimit tek anëtarësia e Partisë Demokratike dhe e komprometuan akoma më shumë reputacionin e saj përballë publikut", thuhet në këtë platformë. Nismëtarët e lëvizjes kërkojnë caktimin e një afati jo më vonë se 9 muaj për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në parti, ku të përfshihen të gjitha institucionet e saj. "Procesi i analizës në parti të drejtohet nga një grup (komision) pune me përfaqësimit të balancuar dhe të ketë në qendër të tij sqarimin dhe transparencën për çështjet e mëdha të Partisë Demokratike, që nisin me marrëveshjen e 18 majit, heqjen nga fushata të simboleve të partisë, hartimin e listave për deputetë, që ndikuan në humbjen e rëndë të 25 qershorit.

Mandati i këtij grupi (komisioni) shkon deri në përfundimin e zgjedhjeve. Kompetencë kryesore e këtij forumi të jetë miratimi i një pakete rregullash, që japin garanci të plota për një proces korrekt zgjedhor brenda PD-së. Krijimin e një komisioni për ndryshimet statutore të balancuara, i cili përpilon dhe harton ndryshimet e nevojshme, ku të garantohen parimet e sipërpërmendura. Ngritjen e një komisioni zgjedhor me përfaqësim të barabartë, që të kryesohet nga një përfaqësues i Lëvizjes për Ringritjen e PD, si garanci minimale për zgjedhje të drejta dhe të barabarta. Ruajtjen e këtij përfaqësimit dhe këtij formati në nivel dege dhe qarku".

KRYETARI

Lëvizja për Ringritjen e PD kërkon që humbja e zgjedhjeve politike të shoqërohet me dorëheqje të menjëhershme dhe të paravokueshme të kryetarit të



Astrit Patozi dhe Genc Ruli

GRUPI I PR

Partia Republikane ka krijuar grupin e saj parlamentar me deputetë të Partisë Demokratike. Siç thotë rregullorja e Parlamentit, grupi parlamentar duhet të ketë të paktën 7 deputetë. Në përbërje të grupit parlamentar të PR janë Fatmir Mediu, Fatbardha Kadia, Hekuran Hoxhalli, Lindita Metaliaj, Isuf Çelaj, Nadire Meçorapaj dhe Orjola Pampuri. Tashmë në Parlamentin e Shqipërisë do të jenë 4 grupe parlamentare, PS, PD, LSI dhe PR.

PROPOZIMET

- 1- Caktimin e një afati jo më vonë se 9 muaj për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në parti, ku të përfshihen të gjitha institucionet e saj.
- 2- Procesi i analizës në parti të drejtohet nga një grup (komision) pune me përfaqësimit të balancuar dhe të ketë në qendër të tij sqarimin dhe transparencën për çështjet e mëdha të Partisë Demokratike, që nisin me marrëveshjen e 18 majit, heqjen nga fushata të simboleve të partisë, hartimin e listave për deputetë, që ndikuan në humbjen e rëndë të 25 qershorit. Mandati i këtij grupi (komisioni) shkon deri në përfundimin e zgjedhjeve. Kompetencë kryesore e këtij forumi të jetë miratimi i një pakete rregullash, që japin garanci të plota për një proces korrekt zgjedhor brenda PD-së. Krijimin e një komisioni për ndryshimet statutore të balancuara, i cili përpilon dhe harton ndryshimet e nevojshme, ku të garantohen parimet e sipërpërmendura.
- 3- Ngritjen e një komisioni zgjedhor me përfaqësim të barabartë, që të kryesohet nga një përfaqësues i Lëvizjes për Ringritjen e PD, si garanci minimale për zgjedhje të drejta dhe të barabarta. Ruajtjen e këtij përfaqësimit dhe këtij formati në të gjitha komisionet e votimit në nivel dege dhe qarku.

Partisë Demokratike. Gjithashtu ata kërkojnë që gara për kryetarin e ri dhe e fosomeve të tjera të garantohet nga një paketë rregullash, që miratohen nga Kuvendi i Partisë. "Mbajtja e përgjegjësisë nuk është akt individual, por normë statutore në PD. Përgjegjësia shkon në përputhje me nivelin e përfaqësimit. Kryetari i partisë, si vendim-

marrësi kryesor, është edhe përgjegjësimmarrësi më i madh", thuhet në material. "Raportet me aleatët dhe me kundërshtarin, koalicionet në opozitë apo në mazhorancë, përcaktohen nga rregulla të qarta statutore, që autorizojnë forumet më të larta të PD-së për të marrë vendimet. PD-ja ka detyrimin të vihet në krye të përpjekjeve për ri-

formatimin e së djathtës në Shqipëri, si forca kryesore e këtij spektri, duke u bazuar në interesa më të gjera se të sajat. Partisë Demokratike i takon misioni i bashkimit të çdo faktori antiqeveritar në vend, për të maksimalizuar aksionin e opozitës duke e trajtuar atë si një lëvizje kombëtare", thuhet në platformë.

MBËSHITESIN PLATFORMËN

- Besnik Mustafaj
- Gent Malko
- Endira Bushati
- Valbona Mezini
- Ridvan Bode
- Igji Cara
- Ardan Kollozi
- Keltis Kruja
- Majlinda Bregu
- Sherrefedin Shehu
- Agron Musaraj
- Rrajmond Hoxha
- Elina Qirici
- Bislim Ahmetaj
- Ibsen Elezi
- Grigelis Muçollari
- Leonardi Olli
- Andi Përmeti
- Ermira Qosja
- Gent Minarolli
- Armand Teiti
- Gjergji Papa
- Zihni Tollozhina
- Astrit Patozi
- Zana Guxholli
- Ilir Kaduku
- Julian Deda
- Kozma Dashi
- Fabian Topollaj
- Ndue Paluca
- Atrid Hoxha
- Kristi Bello
- Gëzim Pani
- Elmi Allmuça
- Pandi Tefëriçi
- Demir Gjana
- Faqion Bathorja
- Genta Boksi
- Gjovalin Bzheta
- Estela Kondura
- Iriat Hyka
- Arbjola Halimi
- Ibrahim Bajrami
- Bedri Hoxha
- Guri Tatar
- Lekë Gjoni
- Vasillaq Ngresi
- Ramadan Hoboçi
- Ramadan Hoxha
- Ardan Shkëlqimi
- Ervin Gjini
- Bedri Luku
- Juela Meçani
- Alesia Reçi
- Pashk Gjoni
- Albert Jorgji
- Zekri Piciri
- Mirgen Lata
- Ermir Gjeta
- Aranit Leka
- Paulin Paqleka
- Hynsi Kërciku



PD-PS ngrenë të enjten komisionin

Çuçi dhe Bylykbashi do të drejtojnë reformën zgjedhore

Bledi Çuçi dhe Oerd Bylykbashi do të bashkëdrejtojnë Komisionin për Reformën Zgjedhore. Ky komision është propozuar nga PD-ja të ketë 18 anëtarë, nga të cilët, 9 do të jenë të PS-së dhe 9 nga opozita. Pritet që komisioni i reformës të ngrihet ditën e enjte në seancën parlamentare. Pritet që demokratët të propozojnë për anëtarë edhe 4 aleatë, ndërsa nuk dihet sa vende do të marrë LSI-ja si forcë e dytë më e madhe në opozitë. Ndërkohë, Partia Socialiste ende nuk ka vendosur nëse do e pranojnë një formulë të tillë që demokratët pretendojnë. Reforma zgjedhore do të jetë konsensuale; kjo dhe për faktin se do të drejtohet me bashkëkryetarë të cilët kanë dhe të drejtën e vetos, çka lë të kuptohet se pa miratimin e dy forcave politike kryesore komisioni nuk mund të marrë asnjë vendim. Sipas projektvendimit të publikuar nga Kuvendi, ky komision do të analizojë të gjitha problematikat e konstatuara në zgjedhje nga partitë politike pjesëmarrëse si dhe rekomandimet e raporteve të OSBE/ODIHR-it. Komisioni do të zhvillojë seanca dëgjimore me ato parti të cilat në zgjedhjet e fundit kanë marrë më shumë se 1% të votave, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në procesin zgjedhor. Komisioni propozohet të ketë një afat 6-mujor.

Deputeti i LSI prezanton nismën

Spahiu: Minatorët duhet të kenë të drejta të barabarta me të tjerët



Deputeti i LSI-së, Përparim Spahiu prezantoi dje, nismën e tij për ligjin "Për statusin e minatorëve". Spahiu tha se ky ligj shërben për "një trajtim dinjitoz për rreth 21.000 minatorë në gjithë vendin, që kontribuuan më shumë se kushdo tjetër në ekonominë kombëtare të 70 viteve të fundit. Indus-

tria e nxjerrjes së mineraleve, ishte dhe mbetet ende zemra e industrisë shqiptare dhe kontribuues kryesor në të ardhurat kombëtare në vite". "Ky projektligj është një zbutje e pabarazisë sociale ndërmjet shqiptarësh që kanë kontribuar në ekonominë e vendit. Projekti bën fjalë për punonjësit të nëntokës që çdo ditë të jetës së tyre, janë

ndarë me familjarët e tyre si për ditën e fundit të jetës", - tha Spahiu. "Projekti, - shpjegoi ai, - synon ta shuajë këtë pabarazi. Nuk kërkohet t'u hiqen përfitimet të tjerëve, por t'u jepen edhe punonjësve të nëntokës të paktën sa të tjerët. Pra, vendosjen në pozitë të barabarta".

Banka e Shqipërisë konfirmoi shifrat e publikuara nga INSTAT në lidhje me rritjen ekonomike në tremujorin e dytë të këtij viti. Guvernatori Gent Sejko tha në një konferencë për shtyp se ekonomia në periudhën prill-qershor të këtij viti kërcëu në 4.06 për qind. Sejko tha se inflacioni vjetor është ngadalësuar në 2.1 për qind, ndërsa papunësia përlllogarit në 13.2 për qind. Banka e Shqipërisë vëren gjithashtu edhe një ulje të kredive me



Guvernatori Gent Sejko

probleme në të gjitha bankat e nivelit të dytë, ndërsa për muajin gusht, guvernatori Sejko deklaroi se balanca buxhetori pësoi suficit. Gjithsesi, sipas guvernatorit,

BSH konfirmon kryeministrin dhe INSTAT

Rritja ekonomike 4.06%, më e madhja që nga 2012-ta

torit, ekonomia shqiptare është ende shumë larg potencialit të vërtetë të saj. "Ekonomia shqiptare është ende larg potencialit të vërtetë të saj, por hendeku po ngushtohet", deklaroi ai. Guvernatori Gent Sejko tha se Banka e Shqipërisë është e gatshme madje edhe të forcojë stimulim monetar,

nëse kjo do të jetë e nevojshme. Inflacioni në dy muajt e fundit ka pësuar rënie, si pasojë e goditjeve kalimtare të ofertës, duke i lënduar pritshmëritë e Bankës Qendrore lidhur me kthimin e rritjes së çmimeve në objektiv. Në analizën e tij për ecurinë e ekonomisë shqiptare, guvernatori nuk la pa përmendur kontributin e shpenzimeve publike në rritjen ekonomike të gjashtëmuajorit të parë. Ndonëse buxheti ngelet në deficit të lehtë, shpenzimet janë rritur ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, duke mbështetur investimet dhe konsumin. Një kontribut pozitiv

në ekonomi ka dhënë edhe rritja e kërkesës së jashtme, e shprehur në rritje të eksporteve dhe të turizmit hyrës. Banka e Shqipërisë shprehur sërish një optimizëm në rritje për sa i takon gjendjes së sistemit bankar. Kreditë me probleme regjistruan sërish një ulje të lehtë gjatë gushtit, duke zbritur në 15.1%. Ulja e kredive me probleme dhe rënia e rrezikut të perceptuar në ekonominë reale, sipas guvernatorit do të përmirësojnë ofertën për kredi në të ardhmen.

Doganat publikojnë listën me 26 subjekte që nuk përfitojnë nga fshirja e detyrimeve

Bizneset që përjashtohen nga falja e detyrimeve të prapambetura

Cilat përfitojnë fshirje të plotë ose me kusht

Ornela Manjani

Drejtorja e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së Aerdhurave
Sektori i Monitorimit të Borxhit

Lista e subjekteve me vendim penal te formes se prere.

Nr.	Dega Doganore	Emri Subjektit	NIPT-i
1	Gjirokaster	A - E 1	J83113606O
2	Vlore	Al.Pi.Carta	L06418205Q
3	Sarande	Alba Oil shpk Sarande	K04105805T
4	Durres	Alfred Idriz Goga	K33710228T
5	Durres	Alfred Ahmet Ahmeti	BD648091O
6	Durres	Alfred Idriz Goga	A00000000B
7	Durres	Alfred Goga	K33710229E
8	Qaf-Thane	Ardian Xhevat Hidri	Z2391251
9	Korçe	Atlas	K53929003K
10	Durres	Beem	J62903035H
11	Durres	Festim Avdulla Lato	A00000000B
12	Durres	Gjergj Mark Prela	K98316501B
13	Vlore	Hasan Morina/kosovar	A00000000B
14	Tirane	Jon Eurotransport	K31424041W
15	Durres	Julian Edmond Loloci	A00000000A
16	Sarande	Klementina Muhamet Rubati	BF1025347
17	Kapshtrice	Lulezim FadiL Sula	pa NIPT
18	Vlore	Sebi	K77327204M
19	Vlore	Soliju	J66828227U
20	Gjirokaster	Standart-A	K62717617S
21	Kapshtrice	Toni	K33717027L
22	Gjirokaster	Versik	J94824820C
23	Kapshtrice	Vjolca Banushi	L16626601J
24	Durres	Zenel Elez Peca	A00000000B
25	Vlore	ALGIS	L16508201H
26	Vlore	HEMA METAL	L16314204J

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave publikoi një listë prej 26 subjektësh që nuk përfitojnë nga ligji "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve". Këto subjekte, të cilat kishin detyrime të vjetra në dogana nuk përfitojnë fshirje detyrimesh, pasi ndaj tyre ka vendim penal të formës së prerë nga gjykata. Ligji për faljen e detyrimeve thotë se nga fshirja e detyrimeve nuk përfitojnë subjektet që kanë detyrime tatimore dhe doganore, të cilat janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe doganore, në kuptim të legjislacionit të fshes.

LIGJI

Në zbatim të ligjit, organi tatimor qendror apo vendor dhe organi doganor përgatisin listën e tatimpaguesve që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve. Kjo listë përditësohet çdo muaj. Listat e detajuara dhe të përditësuara do të shërbëjnë

për njoftim zyrtar të tatimpaguesve që përjashtohen nga zbatim i ligjit. Në zbatim të neneve ligjit nr.33/

2017, degët doganore kryejnë evidencimin e plotë të të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore, bazuar në përcaktimet e ligjit duke marrë në konsideratë datën e vendimit, llojin e mallit, listën e makinerive dhe pajisjeve të përjashtuara nga pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, që ishte në fuqi deri më 31.12.2016. Për këtë qëllim, degët doganore hartojnë

edhe listat respektive të debitorëve sipas procedurave të mëposhtme të përcaktuara në këtë udhëzim. Për të administruar gjithë procedurën e fshirjes sipas këtij ligji, kryetari i degës doganore ngrë një komision në përbërjen e të cilit janë kryetari i degës doganore, juristi i degës doganore, specialisti i borxhit dhe specialisti i financës. Kryetari i degës mund të caktojë në

përbërje të këtij komisioni edhe punonjës të tjerë të degës doganore. Në zbatim të ligjit, dega doganore harton listën e plotë të të gjithë debitorëve, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit mund të konsidero-

het si lista finale mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga komisioni. Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverballi të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit miraton menjëherë fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miraturar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

DETYRIMET QË FALEN PLOTËSISHT DHE ATO ME KUSHT

- Të fshihen detyrimet fiskale përfshirë principlin, kamatëvonesën dhe gjobën për periudhat përpara dhjetor 2010 për të gjithë individët, personat fizikë dhe juridikë, që kanë detyrime të papaguara sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligji.
- Fshihen gjobat dhe kamatëvonesat për periudhën 2011-2014, me kushtin që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të paguhet e plotë tatimit/taksat/tarifa/kontributi.
- Fshirja me të njëjtat kushte e detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë.
- Fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me kushtin e pagesës së kontributit, nisur nga fakti se ky është një kontribut që i është mbajtur të punësuarit nga punëdhënësi dhe si i tillë duhet paguar në buxhet për qëllim të sigurimit të detyrueshëm dhe përfitimt të pensionit.
- Gjobat e gjeneruara nga sistemi në mënyrë automatike për deklarimin e kontributeve, pavarësisht periudhës së cilës i përkasin (ato gjoba që qytetarët e mbajnë mend, në qershor 2016, kur u kalua në sistemin informatik të plotë dhe automatik online). Fshirja e gjobave për deklarimin e kontributeve ishte një premtim i drejtpërdrejtë që kryeministri dhe qeveria ua kaloi drejtpërdrejtë dhe në transparencë të plotë qytetarëve që ato ditë që shoqësimi u bë i ditur.
- Përfshihen këtu edhe rastet e gjobave, referuar neneve të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese.
- Heqja nga qarkullimi dhe regjistrimi i mjeteve të transportit, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim deri më dhjetor 2011, si dhe shuarjen e çdo lloji detyrimi për këto mjete. Gjithashtu, për mjetet e transportit të cilat nuk hien nga qarkullimi, parashikohet shuarja e detyrimeve tatimore për periudhat para 2010 dhe fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave për periudhat 2011-2014, me kusht pagesën e detyrimeve 2011 e në vijim. Para, është parimi i pagesës së principlin për fshirjen e gjobave dhe kamatëvonesave.
- Nisur nga situata e detyrimeve të akumuluara ndërmjet operatorëve të sektorit elektro-energetik me kapital 100% shtetëror dhe sektorit të ujësjellës-kanalizime, si sektorë strategjikë të ekonomisë dhe në reformë të thellë, kemi parashikuar që për këta operatorë të fshihen edhe detyrimet tatimore të papaguara, përjashtuar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrimet e vetëdeklaruar nga këta operatorë dhe që u përkasin periudhave janar 2011 deri dhjetor 2013. Ndërkohë, për këta operatorë, për periudhën janar 2014-dhjetor 2014 do të aplikohet fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave me kusht pagesën brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, e tatimit/taksës/tarifës/kontributit. Para, ndryshimi i vetëm për këta sektorë krahasuar me kategoritë e tjera është periudha 2011-2013, kur fshihen në total detyrimet dhe jo në mënyrë të kushtëzuar, si kompani me kapital 100% shtetëror.
- Fshihen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, të evidencuara në administratën doganore për TVSH-në e shtyrë dhe të paguar për makineritë dhe pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, sipas listës përkatesë në fuqi deri në datë 31.12.2016.
- Nuk përfitojnë nga fshirja sipas këtij ligji, subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, që kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë si të dënuar penalisht për evazion fiskal dhe kontrabandë.

STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në anand të pasurive të paluajtshme:

"Aparatament" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 11, Faqe 32, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 28,123 Euro;

"Ndërtesë" me sipërfaqe 15.5 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Luljeta dhe Sabiela Beqiraj, me Nr. Pasurie 5/61. Çmimi fillestar i ankandit është 22,680 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.10.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Njoftim

Permbauesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në anand pasurine : "Aparatament" me sipërfaqe 73 m² e regjistruar në regjistrin hipotekorë - vol 1, faqe 195, me nr pasurie 2/413+1-17, në ZK 8592 me adresë Qyteti Shkodër. Çmimi fillestar për shitjen në anand është në masën 2,520,000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë . Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 16.10.2017 ora 16:16 në Zyrën e përmbauesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Partalbe Gjakates së rrethit Gjyqësor Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Njoftim

Permbauesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në anand pasurine : "Aparatament" me sipërfaqe 127.7 m², e regjistruar në regjistrin hipotekorë me nr 82 datë 02.06.2011 me volumi 5 faqe 108 me nr pasurie 16/130+1-8, në Zonen Kadastrale 8597 me adresë, lagjia "Pazari", Shkodër . Çmimi fillestar për shitjen në anand është në masën 3,472,000 (tremilionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë . Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 13.10.2017 ora 16:16 në Zyrën e përmbauesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Partalbe Gjakates së rrethit Gjyqësor Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Si u zbuluan dy të rinjtë, u gjendet edhe një armë

Shpërndanin kokainë në Tiranë, arrestohet ushtari profesionist dhe miku i tij

Dy të rinj, të dyshuar si shpërndarës të drogave të forta, janë vënë në pranga nga policia e kryeqytetit gjatë operacionit antidrogë të koduar "Tekstili". Sipas bluve, njëri prej tyre rezultoi ushtari profesionist në Komandën e Forcave Tokësore. Kanë qenë efektivët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim me Komisarjatin Nr.6, që bënë të mundur arrestimin e shtetasit Xhuljano Kasa, 22 vjeç, banues në Tiranë (me funksion ushtar profesionist në Komandën e Forcave Tokësore), si dhe të shokut të tij Denis Ka-

nani, 21 vjeç, banues në Tiranë. Të dy këta persona u konstatuan të ulur në një lokal në rrugën "Llambi Bonata", ku gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e policisë, në tavolinën ku këta dy shtetas ishin ulur janë gjetur qese të tejdukshme me lëndë të dyshuar narkotike, të mbuluara me një xhup. Në vijim janë ushtruar kontrolle në banesat e tyre, ku gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e Xhuljano Kasës, poshtë dyshek-

ut të krevatit është gjetur një qese me sasi të konsiderueshme pluhuri të bardhë (i ndarë në doza), dhe një dokument identifikimi ushtarak, të cilin e paraqiste për t'iu shmangur kontrolleve të policisë, ndërsa gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e Denis Kananit, është gjetur një pistoletë e tipit "Magnum", me kalibër 9 mm. Gjithsej policia ka sekuestruar 79 gr lëndë të dyshuar narkotike të llojit kokainë; 582 gr lëndë të dys-

huar narkotike të llojit kanabis sativa; pistoletë të llojit "Magnum", kalibër 9 mm; 3 telefona celularë dhe dokument identifikimi ushtarak (i shtetasit Xhuljano Kasa). Ky i fundit, me origjinë nga Memaliaj, ishte ushtar profesionist pranë Komandës së Forcave Tokësore në Zall-Herr, ndërsa ka disa profile në rrjetet sociale dhe nuk mungojnë fotot e shumta nga jeta e përditshme. Në njërin prej tyre 22-vjeçari shfaqet në një aktiv-



I arrestuari, Xhuljano Kasa

itet partiak në tubimin e Partisë Socialiste në qershor të vitit 2015, para zgjedhjeve lokale me flamurin e kësaj force politike. Dy të rinjtë akuzohen për

veprat penale "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike, e kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak". xhe.ko.

Masakra e "Urës Vajgurore", kapobanda i Beratit mori hak për vrasjen e të atit

Arrestohet pas 2 vitesh në Itali 'ish-ushtari' i Altin Dardhës

Gëzim Kasemi në '98 vrau 4 vetë, plagosi 2 të tjerë

ITALI

Një 40-vjeçar nga Bera ti është arrestuar në Itali, pasi ishte i dënuar në vendin tonë për një vrasje të kryer 19 vite më parë. Mediat italiane raportuan dje se bëhej fjalë për shtetasin Gëzim Kasemi, i cili u prangos në Bari. Ky i fundit është një nga bashkëpunëtorët e Altin Dardhës, i njohur si kreu i një bande famëkeqe në Berat gjatë periudhës '97-'98. Ndërkohë, mediat italiane shkruajnë se Kasemi kishte mundur të hynte në vendin fqinj në mënyrë ilegale, ndërsa ishte liruar me kusht nga burgu në vitin 2015. Arrestimi i tij u bë me qëllim ekstradimit drejt Shqipërisë, ku do të vuajë dënimin e mbetur prej 3 vitesh, 1 muaj dhe 28 ditë, për veprën penale të "Vrasjes së shumëfishtë, me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armëve luftarakë". Ai akuzohet se më 25 shkurt 1998, së bashku me 3 persona, mes të cilëve edhe Altin Dardha, ka vrarë në një lokal në Berat 4 persona. Burhan Tomorri, vëllai i tij Abdurrahim Tomorri, Behar Esku i dhe Kastrioti Bejko, mbetën të vrarë më 2 shkurt të vitit 1998. Në këtë ngjarje mbetën të plagosur edhe dy persona të tjerë. Shkak për krimin u bë hakmarrja e Altin Dardhës, pasi ai dyshonte se Burhan Tomorri i kishte vrarë babain. Ngjarja në fjalë, në atë kohë u njoh ndryshe edhe si masakra e "Urës Vajgurore". Pas krimit të rëndë, Altin Dardha mundi t'i shpëtonte arrestimit të policisë, por vetëm pak ditë më vonë ai u ekzekutua në Janinë, Greqi. Njëri prej "ushtarëve" të tij, e konkretisht Altin Isufi, u ekzekutua pak minuta pas krimit, në përplasje me policinë. Ndërsa Gëzim Kasemi në atë kohë u prangos në mes të pyllit, teksa ishte i gjakosur. Sipas verdiktit të drejtësisë, ai do të qëndronte çerek shekulli në burg, pasi është cilësuar si një nga autorët e masakrës



I arrestuari, Gëzim Kasemi

KASEMI, GEZIM	
WANTED BY THE JUDICIAL AUTHORITIES OF ALBANIA	
IDENTITY PARTICULARS	
Present family name:	KASEMI
Forename:	GEZIM
Sex:	Male
Date of birth:	24/06/1977 (40 years old)
Place of birth:	BERATI, Albania
Language spoken:	
Nationality:	Albania
PHYSICAL DESCRIPTION	

së shkurtit 1998. **KONFLIKTI** Altin Dardha kishte konflikt të hapur me Burhan Tomorrin, për shkak se këtë të fundit e akuzonte se i kishte vrarë të atin. Për të bërë të mundur vrasjen e Burhan Tomorrit, Dardha ka bashkëpunuar me Gëzim Kasemin si dhe me Altin

Isufin dhe Agron Bilalin. Autorët e kësaj ngjarjeje të rëndë kanë përdorur për kryerjen e vrasjes një automjet tip "Ford" me targa TR 7108 A. Në këtë automjet kanë siguruar një sërë sendesh vetjake që kanë shërbyer për fjetje dhe ushqim, si dhe maska, armët e zjarrit dhe municionin, me

të cilat do të kryhej vrasja. **MASAKRA** Më 25 shkurt të 1998-ës, rreth orës 10:00, pasi janë informuar për vendndodhjen e Burhan Tomorrit, Altin Dardha së bashku me Gëzim Kasemin, Altin Isufin e Agron Bilalin, kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe pasi kanë zbritur nga au-

tomjeti tip "Ford", kanë qëlluar secili me armë zjarri me breshëri në drejtim të Tomorrit. Ky i fundit ka qenë së bashku me 5 persona të tjerë. Si pasojë e ngjarjes mbetën të vrarë 4 persona, ndërsa u plagosën 2 të tjerë. Pas kësaj, autorët u larguan prej andej sërish me automjetin e tyre. Në udhëtim e sipër, në vendin e quajtur "lokali i fiqve", autorët e ngjarjes kanë lënë automjetin "Ford" dhe Altin Dardha ka marrë automjetin tip "Toyota" me targa të Beratit dhe janë larguar drejt fshatit Vodice. Këtu, nën kërcënimin e armës, Dardha ka marrë një tjetër automjet e i ka kërkuar drejtuesit të ecë në drejtim të fshatit Bogdan. Por për shkak të terrenit, drejtuesi nuk ka mundur të ecë më tej, dhe aty autorët e ngjarjes janë larguar duke vrapuar. Gjatë ndjekjes së policisë u vra Altin Isufi.

ARRESTIMI



I dënuar në Itali për drogë, kapet 47-vjeçari

Policia e Tiranës ka arrestuar një 47-vjeçar nga Vora, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafik drogë. Sipas policisë, me qëllim ekstradimiti drejt Italisë, u vu në pranga shtetasi Idajet Spahiu, banues në Vorë (Tiranë). Ky person ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi autoritetet gjyqësore të Sasari/Itali, me vendimin Nr.SIEP 35/2016 të datës 14.06.2017, e kanë dënuar me 4 vite e 7 muaj e 14 ditë burgim për veprën penale "Trafikim i lëndëve narkotike", parashikuar nga nenet 110 & 112 të Kodit Penal Italian dhe neni 73/1, Dekreti 309/1990. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme.



Prangosen 2 shqiptarë pa leje qëndrimi në Itali, u sekuestron kokainë e 3 mijë euro

ITALI - Ishin duke ngrënë në një qebaptore në rrugën "Emilia all'Angelo", në afërsi të urës Crostolo, kur u afruan oficerët e policisë, të cilët po i ndiqnin që kur dolën nga një ndërtesë pak metra më tutje. Sipas medieve të huaja, dy shtetasit shqiptarë, pa leje qëndrimi

në Itali, pasi panë karabinierët, u ndanë dhe tentuan arratisjen në këmbë. Françesko Xhepa, 23 vjeç, u desh të hidhej nga ura për t'i shpëtuar policisë, por u ndalua në rrugën "XX Settembre". U arrestua edhe bashkëkombësi i tij Enert Çollaku, 26 vjeç, që kishte

mbërritur në Itali dy ditë më parë. Gjatë kontrollit të tyre, u gjetën doza kokaine dhe disa qindra euro para cash. Pasi vijuan kontrollin edhe banesën nga e cila dolën pak më parë, karabinierët zbuluan edhe 104 gramë kokainë të tjera si dhe 3 mijë euro.

Nëse do të shitej në treg sasia e drogës së gjetur në banesë, do të përfitoheshin rreth 6.000 euro. Po ashtu u gjetën edhe pajisje për paketimin e drogës. Operacioni antidrogë nisi pas raportimeve të banorëve të zonës.

Operacioni, përfundon në pranga edhe shoku i tij, 34-vjeçari Genti Nderjaku

Agron Lisi

DURRËS

Deklaratat e ambasadorit amerikan Donald Lu kanë vënë në lëvizje policinë e Durrësit. Dy persona, pjesë e një bande kriminale, u arrestuan dhe nga blutë e qytetit bregdetar. Mësohet se në njëri nga personat që u vu në pranga është i riu Marjel Fierza, me precedentë penalë. I arrestuari Fierza evidentohet në një raport të Ministrisë së Brendshme, si pjesë e bandës së Durrësit. 30-vjeçari u ka shpëtuar tre atentateve në vitin 2010 dhe 2012. Ndërkohë, burime nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit mbrëmë bënë me dije se "në zbatim të Plan-Operacionit 'Vjeshhtë 2017', në bazë të informacioneve nga strukturat policore për mbajtjen nën kontroll dhe goditjen e grupeve kriminale janë arrestuar në flagrancë shtetasit: Marjel Fierza, 30 vjeç dhe Genti Nderjaku, 34 vjeç, të dy banues në Durrës. Arrestimi i tyre u bë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në mjedinjtin tip 'Porche', me drejtues shtetasin Marjel Fierza, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provave materiale: 2 pistoleta tip 'Beretta'; automjeti tip 'Porche' dhe 6 telefona celularë. Kontrollat do të vijojnë edhe në ditët në vijim".

I gjenden dy pistoleta në makinë, arrestohet pjesëtari i bandës së Durrësit

Marjel Fierza u shpëtoi 3 atentateve në vitet 2010-2012



Sendet dhe armët që iu sekuestruan 30-vjeçarit Fierza



Vendi ku ndodhi atentati ndaj Marjel Fierzës në vitin 2012

ATENTATET NDAJ MARJEL FIERZËS

Në prill të vitit 2012, Marjel Fierza u qëllua me 20 plumba. Në atë kohë, djali i një biznesmeni durrsak i ka shpëtuar për mrekulli një atentati të mirorganizuar, i ndodhur ditën për ditël në qytetin bregdetar. Ngjarja e

rëndë ndodhi në orën 13:45 të datës 18 prill, në afërsi të Urës së Dajlanit, kur Fierza ishte duke udhëtuar me makinën e tij "Fiat Morena" me targa AA 727 CL. Në drejtim të automjetit të menaxherit është qëlluar plot 20 herë me një armë automatike "Scorpions". Për fat të mirë, asnjë nga plumbat

nuk e ka kapur 25-vjeçarin. Pas ngjarjes, burime nga policia e qytetit bregdetar bënë të ditur se i dyshuar për atentatin ndaj Fierzës është Aldo A., nga Shijaku, i cili është shpallur në kërkim dhe pavarësisht kërkimeve nuk është bërë i mundur arrestimi i tij deri në orët e vona të mbrëmjes. Zyr-

tarë të policisë thanë se atentati ndodhi për shkak të përplasjeve të vjetra që Fierza ka pasur me Aldo A. Sipas bluve, i riu po kthehej nga spitali i qytetit të Durrësit në drejtim të zonës së Plepave, ku pak metra sapo kishte kaluar Urën e Dajlanit ka rënë pre e një atentati të mirorganizuar. Nga hetimet e para rezultoi se persona që udhëtonin me një "Benz 250" blu, kanë qëlluar me një armë automatike "Scorpions" në drejtim të makinës që drejtonte Fierza. I riu, i cili merret me menaxhimin e një hoteli në qytetin bregdetar, pronë e familjes, i ka shpëtuar dy vite më parë edhe një tjetër atentati. Në shtator të 2010-ës ai është qëlluar nga persona që ende nuk janë identifikuar. Edhe atë kohë, Marjel Fierza shpëtoi për mrekulli. Po atë vit, një muaj më vonë, Fierzës iu shpërthye

me tritol makina tip "BMW, e cila ndodhej e parkuar para pallatit ku banonin prindërit e kryeprokurores Ina Rama. Atentati ndaj Marjel Fierzës, dyshohet të ketë ndodhur për shkak të përplasjeve të vjetra që ai ka pasur me Aldo A. nga Shijaku. Në vitin 2007, Aldo A. është qëlluar me armë, ku dhe ka mbetur i plagosur. Marjel Fierza ka qenë një prej të dyshuarve për këtë ngjarje, por ndaj tij nuk pati prova dhe fakte që të vërtetonin pjesëmarrjen e tij në krim. Pavarësisht faktit se Fierza e kishte "pastruar" figurën e tij ligjshisht, duket se Aldo A. nuk ia ka falur, ndaj për këtë shkak ka vendosur ta qëllojë në mes të ditës, duke tentuar t'i marrë jetën. Për sa i përket shpërthimit të makinës së Fierzës, policia tha se nuk ka të dhëna nëse Aldo A. ka lidhje me këtë ngjarje.

Implemented by **giz** German Development Cooperation

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Provider – Call for Proposal and Expression of Interest

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under the component of Technical Vocational Education & Training, will cooperate with Private Vocational Training providers in the country, with the aim to scale-up VET programs, complementary to the courses offered by Public VET providers.

In this respect the programme is conducting a Call for Proposals and Expression of Interest from 26 September – 15 October 2017.

The Call for Proposals and Expression of Interest shall help to identify private entities that can offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- training/courses with 3 - 6 months training duration for about 50 - 150 participants, targeting young people at the age of 19-34 years. 40% of the participants are female and 30% of the trainees are young returning migrants from EU countries.
- demand-driven and work-based VT short-term courses relevant to the local labour market that lead to employment of the stated target group. The proposals should explain how employment of min. 50% of the participants after completing the training measure can be achieved.
- There is no limitation in terms of geographical location, though high preference will be given to the locations where available vocational training offer by either public or private VET providers is non-existent or very limited. The courses should be in line with the following prioritized sectors – ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear, innovative/creative crafts.

The 5-7 proposals that are to be selected through this call shall receive financial support in the amount between 30,000 – 50,000 EUR (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the programme budget of 250,000 EUR assigned for this activity is allocated. The project implementation timeframe is up to 1 year (12 months).

Selection Procedure:

First step: All Call for Proposals and Expression of Interest received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potential qualified candidates will be invited for an interview and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the 5-7 companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive Expression of Interest format and Evaluation Grid.

For further questions, please, contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 26 September-14 October 2017.

Raporti i MB: Marjel Fierza është "ushtar" i Lul Berishës

Një raport i Ministrisë së Brendshme, i publikuar në prill të vitit 2016, tregon se 30-vjeçari Marjel Fierza është "ushtar" i Lul Berishës, njeriu që e drejtoi për 10 vjet me radhë "Bandën e Durrësit" mes vrasjesh, trafikesh droge dhe armësh. Raporti fliste për bashkim të Berishës me Emiljano Shullazin. Në të jepeshin të dhëna se aktiviteti i dy kapobandave ishte ai i gjobitjes së disa personave, biznesmenë të njohur në fushën e basteve sportive, tregtisë së kafesë dhe tregtisë së naftës. Dokumenti sekret sak-

tësonte se Lul Berisha e drejtonte bandën e tij nga burgu dhe i delegonte urdhrat të njerëz të besuar si Julian Meçaj, Marjel Fierza, Mond Çekiçi, si dhe Plarent Dervishaj, për të cilin në prill të 2015-ës, Apeli i Krimeve të Rënda i ka pushtuar të gjitha akuzat. "Pjesë e grupit të bashkuar janë Lulzim Berisha 'Luli', Emiljano Shullazi 'Mili', Plarent Dervishaj 'Lenti', Edmond Koçi, ose 'Mond Çekiçi', Marjel Fierza, Julian Meçaj, Gilmando Dani dhe Blerim Shullazi", thuhet në raport.

Biznesmeni i Lushnjës: Dikush më mori në telefon, u prezantua si Shullazi

Nuk e njoh Shullazin, nuk e kam takuar ndonjëherë", ka rrëfyer dje para Gjykatës së Krimeve të Rënda, Adriatik Kërçuku, në biznesin e të cilit është hedhur tritol. I thirrur si dëshmitar i prokurorisë në procesin gjyqësor ndaj Emiliano Shullazit dhe miqve të tij, Kërçuku tha se nuk njihë asnjë nga të pandehurit, ndryshe nga dëshmia e mëparshme, ku u shpreh se Shullazi e kishte ofenduar dhe kërcënuar në telefon. Gjatë seancës, biznesmeni nga Lushnja rrëfë se i vetmi kontakt që ka pasur me Shullazin është një telefonatë që kishte marrë nga një person, i cili ishte prezantuar si ai. Një muaj nga kjo telefonatë, në 25 janar 2016, në oborrin e biznesit të tij të dyer-aluminit shpërtheu një sasi tritol, që shkaktoi dëmtime materiale, por pati të lënduar në njerëz. "Nuk e njoh Shullazin, s'e kam takuar ndonjëherë. Unë isha në Durrës kur më mori magazinieri im dhe më kaloi dikë në telefon. M'u prezantua si Emiliano Shullazi, më tha që duhet ta takoja. As nuk më kërcënoi dhe as



Emiliano Shullazi në gjykatë

nuk më ofendoji, unë nuk i dhashë rëndësi. Nuk kam pasur asnjë komunikim tjetër me të. Një muaj më prapa më është vënë ekspoziv tek pronat", deklaroi Adriatik Kërçuku në gjyq. Ai shtoi se kamerat e sigurisë së biznesit të tij nuk ishin funksionale atë ditë. Gjithashtu, gjatë dëshmisë, biznesmeni dha përgjigje të shkurtra dhe shpesh tha se nuk mbante mend shumë situata, të njëjtin reagim mbajtën edhe dy dëshmitarët e tjerë. Për këtë shkak prokuroria kërkoi kundërshtimin e pjesëmë të dëshmitëve me deklarimet e dhëna prej tyre gjatë hetimit. **in.al**

"Djali nuk ka konflikte me askënd. Ngjarja mund të ketë marrë shkas për shkak të detyrës që ka pasur"

U sulmua nga maskat, ish-kreu i SHIK-ut ikën nga Shqipëria

Liri Dauti: Im bir, Artani erdhi për mua nga Italia se isha sëmurë

Eneida Petova

BERAT

Një ditë pas sulmit me mjete të forta nga dy persona të maskuar, ish-kreu i SHIK-ut në Berat në vitet 1993-1996, Artan Dauti është larguar nga Shqipëria. 48-vjeçari, edhe pse në gjendje jo të mirë shëndetësore për shkak të dhunës ai përfundoi në spital, mëngjesin e djeshëm ka lënë qytetin e Beratit dhe Shqipërinë dhe është larguar në Itali, ku dhe jeton prej 20 vitesh me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij. Ndërkohë, nëna e tij, Liri Dauti, e cila jeton në lagjen "29 Nëntori" të këtij qyteti, deklaroi se i biri është larguar për në Itali pa mbushur 24 orë nga ngjarja e ndodhur në afërsi të banesës së saj. E moshuara pohoi se sulmin ndaj djalit të saj e ka mësuar ditën e djeshme dhe se kjo ngjarje mund të ketë ndodhur për shkak të detyrës që ai ka pasur shumë vite më parë në Berat, pasi ai nuk ka konflikte me askënd. Gjithashtu, Liri Dauti u shpreh se djali i saj, Artani erdhi nga Breshia e Italisë për të parë atë, pasi kishte probleme shëndetësore për shkak të moshës. Sipas saj, Artani ishte përgatitur për t'u nisur, pasi nuk mund të qëndronte më shumë se katër ditë për shkak të punës në Itali, ku nuk kishte mundur dot të merrte më shumë ditë leje, por saktësisht për ditën dhe orën e nisjes e moshuara nuk ka pasur dijeni. Nga ana tjetër, burime nga spitali i Beratit thanë se Artan Dauti ka dalë nga ky spital ende pa u kurrar dhe përmirësuar, duke deklaruar se do ta vazhdojë kurimin në shtetin ku jeton. Ndërkaq, burime nga policia lokale pohuan se po hetohet intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të dy agresorëve që dhunuan barbarisht ish-kreun e SHIK-ut në Berat. Sipas bluve, janë marrë në pyetje disa persona që kanë qenë afër vendit të ngjarjes. Pavarësisht hetimeve të kryera, ende nuk është bërë i mundur zbulimi i dy agresorëve. E tronditur nga ngjarja, nëna e 48-vjeçarit deklaroi në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" se policia duhet të zbardhë sa më shpejt ngjarjen.

Zonja Liri, kur është kthyer djali i saj nga Italia dhe prej sa vitesh jeton ai atje?

Që pasi e hoqën nga puna në fund të vitit 1997, djali im me gruan dhe fëmijët ka ikur në Itali. Katër ditë më parë erdhi për të më parë mua, pasi kam qenë e sëmurë. Ndërsa gruan dhe fëmijët i la atje, sepse janë në shkollë. Nuk mund të rrinte më shumë, pasi



Ish-kreu i SHIK-ut në Berat, Artan Dauti



Liri Dauti, duke folur për "GSH"



Vendi ku u sulmua ish-kreu i SHIK-ut

është në punë. Im bir, Artani iku sot (dje) në Itali. Unë e dija që do të ikte sot (dje), por se në çfarë ore do të nisej këtë nuk e di me saktësi. Ai u nisqë në mëngjes, pasi pas asaj që i ndodhi djalit mbremë nuk mund të rrinte dot më gjatë nga frika e një agresioni të mundshëm. **Si e mësuar ju ngjarjen që ndodhi me djalin tuaj**

mbremjen e së hënës?

Sic ju thashë, unë kam qenë e sëmurë, sa nga moshja, sa nga tensioni, dhe për këtë djali u kthye për të më parë. Edhe mbremë (të hënën) djali ishte tek unë. Qëndroi disa orë dhe u largua. Sapo ka dalë prej këtej, e goditën, nuk e di se kush. Unë sot (dje) në mëngjes e kam mësuar ngjarjen. Nga familjarët e tjerë e

DHUNA NDAJ ARTAN DAUTIT

Mbrëmjen e së hënës, rreth orës 18:30, dy persona ende të paidentifikuar sulmuan ish-kreun e SHIK-ut në Berat, Artan Dauti. Sapo 48-vjeçari ka dalë nga banesa e nënës së tij dhe po hynte në automjetin që kishte parkuar në rrugicën e lagjes "29 Nëntori", ai është goditur me mjete të forta nga dy persona të maskuar. Autorët u larguan me shpejtësi nëpër rrugicat e errëta të lagjes, pasi dëgjuan zhurma njëri-zësh që po afroreshin në vendngjarje.

kam mësuar, se dje askush nuk më tregoi gjë. I dëgjoja që ishin të shqetësuar, por nuk më treguan gjë për shkak të shëndetit. Sot (dje) në mëngjes më thanë se Artani ka ikur në Itali, pasi një natë para e kishin goditur të lagja.

Çfarë ju thanë në lidhje me ngjarjen?

Më thanë se Artani ishte qëlluar sapo doli nga shtëpia ime për të ikur te shtëpia e prindërve të nuses së tij, pasi ai nuk ka shtëpi këtu në Berat. Këtu afër te lagja paska ndodhur ngjarja, ku dy çuna

e kanë rrahur. Kaq di unë. **Përse mund të ketë ndodhur sulmi ndaj djalit tuaj?**

Djali im nuk ka probleme me asnjë njeri. As ai dhe as 3 djemtë e tjerë apo familjarët tanë. Kjo është hera e parë që djali vjen në Berat që kur ka ikur në Itali. Dhe ai erdhi për të më parë mua. Unë nuk di asgjë se përse ka ndodhur dhe se kush e ka bërë. Këtë le ta gjejë policia, por mendoj se mund të ketë lidhje me punën që ka bërë më parë si kreu i SHIK-ut Berat, para se të largohej nga Shqipëria, pasi arsyet tjetër nuk ka.

"Që prej 10 ditësh nuk kemi kontaktuar me Ilian"

35-vjeçari u zhduk në kufirin greko-shqiptar, kunati: Dyshojmë se mbahet peng nga trafikantët



35-vjeçari grek Ilija Ntrikos

Thesproti. Kështu dhe ne, duke përjetuar këtë me vjeçarin, mendojmë se ndoshta Ilija është përballur me trafikantët droge dhe ata

kanë dashur t'i mbyllin gojën. Lutemi të mos e ketë paguar me jetën e tij këtë gjë. Nuk duam të mendojmë se e kanë vranë. Ndoshta e

kanë marrë dhe ditët në vijim e lënë të lirë. Mendja jonë shkon kudo", - tha për "protothema.gr", kunati i 35-vjeçarit. Çobani 35-vjeçar foli për herë të fundit me gruan e tij në orën 11:30 të së dielës së 24 shtatorit, kur ajo e telefonoi për t'i thënë se ishin të ftuar për drekë nga shtëpia e nënës së saj. Ilija i tha se ndodhej në stan dhe do nisej për në shtëpi. Ky ishte dhe komunikimi i fundit me Ilija Ntrikon. Prej orës 12:00 të së dielës, Ilija ndaloj së përgjigjuri në telefon. Në stan u gjet makina me çelësin në kuadër, por dhe telefoni i tij, portofoli dhe gjithë sendet e tij personale.

SHKURT

Ndodja e bregdetit në 2015, nën akuzë kapitani i "Bridge"

DURRËS - Trageti "Bridge" i linjës Durrës-Bari e Durrës-Ankona është shkaktoni i ndotjes masive të plazhit të Durrësit më 7 nëntor të vitit 2015. Në këtë konkluzion ka dalë prokuroria e qytetit bregdetar, pas hetimit që ka zgjatur plot dy vjet. Ndërkohë, janë vënë nën akuzë kapiteni grek dhe pjesëtarit i ekipazhit të kësaj anijeje. Derdha e një sasive të konsiderueshme vaji dhe karburanti shkaktoi ndotje masive në bregdetin e Durrësit (nga sektori "Iliria" deri te sektori "Teuta"), në një sipërfaqe prej 2.5 km.

Maskat plagosin në pritë 2 të rinj, u djeqin dhe mjetin

TROPOJË - Policia e Tropojës ka dhënë detaje të reja në lidhje me ngjarjen e ndodhur mbremjen e së hënës në aksin rrugor Tropojë-Lekbibaj, në vendin e quajtur "Shkëmbi i Rajzës", ku persona të maskuar dhe të armatosur u kanë zënë pritë dy të rinjve, duke i plagosur. Sipas bluve, të plagosurit janë Fatjon Markaj, 29 vjeç dhe Ermal Rosaj, 27 vjeç, të cilët u udhëtonin me një kamioncinë. Mësohet se agresorët, pasi kanë qëlluar me armë në ajër, kanë plagosur dy të rinjtë me mjete të forta. Në largim e sipër, ata kanë dëgjur edhe kamioncinën e të plagosurve.

Terrorizoi gruan dhe fëmijët e tij të mitur, arrestohet 38-vjeçari

KORÇË - Policia e Korçës ka ndërhyrë në kohë në një ngjarje në fshatin Velitërnë, duke parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konfliktit të mprehtë në familje. Blutë kanë arrestuar në flagrancë 38-vjeçarën Festim Kume, banues në këtë fshat, pas telefonatës së bërë nga gruaje e tij D. Kume te numri 129. Duke qarë, 38-vjeçarja ka kërkuar ndihmën e policisë, pasi bashkëshorti po dhunonte fizikisht atë dhe dy fëmijët e mitur.

Maturantët jofitues të monitorojnë në kohë reale zhvendosjen e vijës së kuqe

Universitetet, ndryshon afati për kuotat e paplotësuara MAS: Ja kur duhet të regjistroheni

Voltiza Duro

P prej datës 1 tetor kanë nisur regjistrimet në universitetet publike e private për të gjithë studentët e shpallur fitues në raundin e dytë, i ndarë në 7 faza 48-orëshe. Deri më 14 tetor, të gjithë studentët kanë mundësi të paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve me dokumentacionin përkatës për të vijuar më tej me procedurat. Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla ka firmosur udhëzimin në të cilin publikohen të gjithë hapat që duhen ndjekur jo vetëm për regjistrimin, por edhe për maturantët të cilët ende nuk janë shpallur fitues në një program studimi e janë në pritje. "Periudha 1 tetor deri në 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.




Ministria e Arsimit

Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga universitetet private të cilat nuk parashikojnë kriteret shtesë, nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe, - bëhet me dije në udhëzimin e MAS. Të gjithë maturantët jofitues duhet të monitorojnë në kohë reale portalin "U-Albania", pasi në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, bëhet zhvendosja e vijës së kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këto faza do të vijojnë deri në plotësimin

UDHËZIMI I FIRMOSUR NGA NIKOLLA
"Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga universitetet private të cilat nuk parashikojnë kriteret shtesë, nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe", - thuhet në udhëzimin e MAS.

e kuotave dhe mbylljen e procesit të regjistrimeve në 14 tetor. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara që nuk kanë aplikantë në pritje, do të bëhet rikthimi në garë i kandidatëve të

shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në degë të tjera. "Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e rënditit sipas pikëve të fituara mbas vijës



Udhëzimi i firmosur nga Lindita Nikolla

së kuqe, brenda datës 24 tetor 2017", - citohet në udhëzimin e ndryshuar të Ministrisë së Arsimit. Ndërkaq, IAL-të brenda datës 27 tetor të këtij viti, do të dërgojnë në QSHA listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike, e për të gjithë emrat e studentëve që do të dërgohen pas kësaj date, nuk do të procedohet me dhënien e

numrave të matricullimit e QSHA do kërkojë rregjistrimin e tyre. Ndërsa për të gjithë ata kandidatët fitues, të pajisur me diploma të huaja, bëhet fillimisht njohja e diplomave, e pas kësaj Qendra e Shërbimeve Arsimore kryen regjistrimin përfundimtar të tyre. Ky udhëzim i firmosur nga Nikolla ka hyrë në fuqi menjëherë pas ndryshimeve të bëra.



Nis ndërtimi i katër rrugëve të Ndroqit

Bashkia e Tiranës po vijon punën për ndërtimin e rrugëve të brendshme të fshatit Ndroq, e ky investim synon afrimin e banorëve që tregtojnë produktet bujqësore të zonës në tregjet e Tiranës. Kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi punimet për ndërtimin e katër rrugëve të reja dhe theksoi se investimet do të shtrihen në nivel kapilar në çdo zonë të kryeqytetit. Ai deklaroi se vëmendje po i kushtohet urbanizimit të zonave rurale, duke ruajtur të njëjtën cilësi të punimeve. "Kemi bërë disa teste, si në Krrabë, Vaqar, Pezë, Ndroq, e na rezultuan se, shkuarja e investimeve në nivel kapilar është mënyra më e mirë për të ecur përpara me urbanizimin e zonave rurale të Tiranës", - u shpreh Veliaj. Ai theksoi se investimet e realizuara do të rrisin vlerën e pronës së qytetarëve dhe do të japin zgjidhje edhe rritjes së numrit të banorëve në vitet e ardhshme, duke krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të jetuar edhe në zonat rurale. Administratori i Njësisë Administrative Ndroq, Xhavit Çeka falënderoi Bashkinë e Tiranës për kujdesin e treguar për përmirësimin e infrastrukturës së kësaj zone, e cila nuk kishte njohur investime prej më shumë se 20 vitesh.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: RFP - "Operationalization of mobile physical delivery channel to increase service access in remote areas in Albania".

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP Procurement Notices 41386 - RFP - Operationalization of mobile physical delivery channel to increase service access in remote areas in Albania.**

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than October 20, 2017, 14.30 pm.

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Inspektori: Identifikojmë 90 të tilla vetëm në Tiranë

Policia Bashkiake aksion për heqjen e mjeteve të braktisura, vetëm 15 ditë kohë

Policia Bashkiake, në bashkëpunim me atë Rrugore, kanë ndërmarrë aksionin për identifikimin dhe spastrimin e rrugëve nga automjetet e braktisura. Në momentin që një mjet do të dërgojë mbi 2 javë në rrugë dhe parkime, do të konsiderohet i braktisur dhe mund të konfiskohet nga policia në një pikë të caktuar grumbullimi. Në këtë kategori do të përfshihen edhe automjetet që janë pa targa, të dëmtuara apo të djegur e kanë bllokuar vendqëndrimet për muaj me radhë. Toni Beni, inspektor në Policinë Bashkiake, tha se ky aksion konsiston në tri faza. "Faza e parë ka filluar me njof-

timet që na kanë ardhur nga qytetarë të ndryshëm në adresën e Policisë Bashkiake për mjete të cilat janë të braktisura prej disa kohësh e që kanë zënë hapësirat publike ose sheshet e përbashkëta. Nga kjo është bërë identifikimi i të gjitha mjeteve në qytetin e Tiranës, të cilat janë rreth 90 mjete në të gjithë njësitë administrative që mbulon kjo bashki", - tha inspektori. Ai u ka bërë thirrje të gjithë pronarëve që të bëjnë lëvizjen e automjeteve brenda një afati kohor prej 15 ditësh. Faza e tretë, sipas Toni Benit do të jetë spostimi i këtyre mjeteve drejt një vendi të përcaktuar nga policia rrugore.

LOTARIA AMERIKANE UDHEZIMI

Regjistrimi online falas, informacioni që duhet të plotësoni për t'u shpallur fitues

Llotaria, udhëzimi i SHBA, si të aplikoni

Zyrtarët: Do zgjidhen jo më shumë se 7% nëpër shtete

Voltiza Duro

PAGESAT

Mos i dërgoni para askujt për tarifën e DV-së nëpërmjet postës, Western Union, ose kujt do shërbimi tjetër dërgesash nëse jeni duke aplikuar për një vizë emigrimi në një Ambasadë ose Konsullatë të Shteteve të Bashkuara. Arkëtarë konsullor do ju japë menjëherë një faturë të qeverisë së SHBA-së për pagesën."

Mesditën e ditës së djeshme ka nisur zyrtarisht aplikimi për Lotarinë Amerikane, ku SHBA ka vënë në dispozicion 50 mijë viza për ata që do të shpallen fitues në të gjithë botën. Edhe këtë vit, Shqipëria është në listën e vendeve që mund të përfitojë deri në 7% të totalit të vizave. Përzgjedhja e fituesve do të bëhet në mënyrë rastësore nëpërmjet shorteut kompjuterik. Për të gjithë të interesuarit, aplikimi do të bëhet deri në 7 nëntor 2017. Por Ambasada Amerikane thekson se kandidatët nuk duhet të presin javën e fundit të periudhës së regjistrimit, pasi mund të shkaktohet mbingarkesë e faqes së internetit prej kërkesave të shumta. Në faqen zyrtare të ambasadës, jepet linku <https://goo.gl/5SjV6h> me udhëzimet përkatëse për çdo të interesuar që dëshiron të jetojë në SHBA.

KRITERET

Të gjithë aplikantët që do të përzgjidhen nga lotaria, duhet të plotësojnë kërkesa të thjeshta, por të rrepta, të pranueshmërisë në mënyrë që të kualifikohen për një vizë shumëllojshmërie. Individët të jenë të lindur në një vend të kualifikueshëm për programin e DV-2019, ku Shqipëria hyn në mesin e shteteve që e përfitojnë lotarinë. Ligji dhe rregullat e Emigracionit të Shteteve të Bashkuara kërkojnë që çdo aplikant duhet të ketë të paktën një arsim të shkollës së mesme ose ekuivalentin e saj, ose brenda pesë viteve të fundit të ketë dy vjet përvojë pune në një profesion që kërkon përvojë ose trajnim të paktën dy vjet. Një "arsimim i shkollës së mesme ose ekuivalente" përkufizohet si përfundimi me sukses i një kursi dymbëdhjetëvjeçar fillor dhe të mesëm në Shtetet e Bashkuara ose përfundimin e suksesshëm në një vend tjetër

të një kursi arsimi zyrtar të krahasueshëm me filloren dhe të mesmen të një shkolle në arsimin e mesëm në Shtetet e Bashkuara. Vetëm kurset zyrtare të studimit e përbushin këtë kërkesë; kurset e korrespondencës, me kohë të pjesshme, ose certifikata të ngjashme (të tilla si me kohë të pjesshme G.E.D.) nuk janë të pranueshme. Prova të dokumentuara të edukimit ose përvojës së punës duhet t'i prezantohen zyrtarit konsullor në kohën e intervistës për vizë. Nëse aplikanti nuk i

përbush kërkesat për edukim ose për përvojë pune, regjistrimi i tij do të skualifikohet në ditën e intervistës për vizë dhe as atij e as anëtarëve të familjes së tij nuk do t'iu lëshohet vizë. Departamenti Amerikan i Shtetit bën me dije se një tjetër kriter është aplikimi online, ndërkohë thekson se aplikimet me letër ose aplikimet e vonuara nuk do të pranohen. Në bazë të ligjit, lejohet vetëm një regjistrim për çdo person gjatë periudhës së regjistrimit; në të kundërt, ata individë që do konstatohen që kanë aplikuar më shumë se një herë gjatë periudhës 3 tetor-7 nëntor 2017, do të skualifikohen. Ndërkaq, aplikantët duhet të kenë kujdes të përfshijnë në regjistrim bashkëshortin/en, në të kundërt do të ndodhë skualifikimi i aplikantit kryesor dhe refuzimi i të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Kjo vlen dhe për mospërfshirjen në regjistrimin për lotarinë të të gjithë fëmijëve që kanë të drejtë, çka sjell skualifikimin e aplikantit. Në njëftim bëhet me dije se nuk ka një moshë minimale për të aplikuar për programin, por kërkesa për shkollim nga një shkolle e mesme ose përvojë pune për secilin aplikant primar në kohën e aplikimit do të ndikojë në skualifikimin e shumë personave që janë nën 18 vjeç.

REGJISTRIMI
Aplikantët duhet të plotësojnë Formularin Elektronik të Regjistrimit për Vizën e Shumëllojshmërisë online në faqen zyrtare www.dvlottery.state.gov. Regjistrimet e papërfunduara nuk do të pranohen ndërsa bëhet me dije se regjistrimi për Programin e Lotarisë është falas. "Jeni ? inkurajuar të plotësoni vetë formularin e regjistrimit, pa ndihmën e një 'këshilluesi për vizë', 'agjenti të vizave' ose personave të tjerë që ju ofrojnë ndihmë. Nëse është dikush tjetër që ju ndihmon, duhet të jeni të pranishëm në momentin e përgatitjes së regjistrimit, në mënyrë që



t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve në mënyrë sa më të saktë, të merrni faqen e konfirmimit dhe numrin e konfirmimit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të pajiseni me faqen e konfirmimit dhe numrin e konfirmimit. Pa këtë informacion, nuk do të jeni në gjendje të hyni në sistemin online, i cili do t'ju informojë mbi statusin e regjistrimit tuaj. Duhet të jeni të kujdesshëm në rastin

ku dikush ofrohet të ruajë faqen tuaj të konfirmimit dhe numrin tuaj të konfirmimit. Ju gjithashtu duhet të kenë akses të posta elektronike që keni vendosur të regjistrimi juaj në E-DV", bëhet me dije në udhëzimin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

INFORMACIONI QË KËRROHET

Në udhëzimin e publikuar nga Ambasada Amerikane theksohet se aplikanti duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm për të plotësuar regjistrimin E-DV, ku duhet të japë emrin, gjininë, datën e lindjes, vendin e lindjes, vendin ku jeton, adresën postare, adresën e email-it dhe fotografitë të marra brenda gjashtë muajve të fundit, të kandidatit kryesor, bashkëshortit dhe të gjithë fëmijëve. Aplikimi për vizë mund të refuzohet nëse fotografitë janë manipuluar ose nuk plotësohen specifikimet. Gjithashtu, kandidatët duhet të shënojnë nivelin më të lartë të arsimit, statusin aktual martesor dhe numrin e fëmijëve të pamartuar nën moshën 21 vjeç. "Duhet të siguroheni që të përfshini të gjithë fëmijët biologjikë; të gjithë fëmijët ligjshëm të birësuar nga ju; dhe, të gjithë fëmijët/thjeshtërit nga martesat e mëparshme që janë të pamartuar dhe nën moshën 21 vjeç në datën e aplikimit tuaj elektronik, madje edhe në qoftë se ju nuk jeni më të martuar ligjërisht me prindin e fëmijës, dhe madje edhe në qoftë se fëmija aktualisht nuk banojnë me ju dhe/ose nuk do të emigrojnë me ju", thuhet në udhëzimin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Moslistimi i të gjithë fëmijëve që kanë të drejtë të

1 ORË KOHË

"Aplikantët do të kenë gjashtëdhjetë minuta kohë, që fillon me shkarkimin dhe plotësimin e formularit, deri në përfundimin dhe regjistrimin në adresën e internetit të E-DV-së. Nëse më shumë se gjashtëdhjetë minutat kalojnë dhe kandidati nuk e ka përfunduar dhe regjistruar formularin në mënyrë elektronike, informacioni i dhënë deri në atë moment do të fshihet."

KRITERET PËR TË FITUAR

1. Individët duhet të kenë lindur në një vend të kualifikueshëm për programin e DV-2018.
2. Çdo aplikant duhet të ketë të paktën një arsim të shkollës së mesme ose brenda pesë viteve të fundit të ketë dy vjet përvojë pune në një profesion që kërkon përvojë ose trajnim të paktën dy vjet.
3. Aplikimet me letër ose aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
4. Lejohet vetëm një regjistrim për çdo person gjatë periudhës së regjistrimit.
5. Aplikantët duhet të kenë kujdes të përfshijnë në regjistrim bashkëshortin/en, në të kundërt do të ndodhë skualifikimi i aplikantit.
6. Nuk ka një moshë minimale për të aplikuar për programin, por kërkesa për shkollim nga një shkolle e mesme ose përvojë pune për secilin aplikant primar në kohën e aplikimit do të ndikojë në skualifikimin e shumë personave që janë nën 18 vjeç.





Nëse aplikanti ka marrë një postë elektronike apo email ku njoftohet se aplikimi i tij për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdojë me aplikimin i duhet të dërgojë një shumë parash në emër të një personi, mund të jetë viktimitë e një mashtrimi. Vitet e shkuara, aplikantët fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK) me anë të postës, jo me email, dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapat e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk u kërkon kandidatëve t'u dërgojnë para atyre, apo ndonjë Ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Western Union. Disa adresa interneti mund të tentojnë të çorëtojnë aplikantët duke i bërë të mendojnë që ato janë adresat zyrtare të internetit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojsh-

Ambasada: Nuk ka asnjë pagesë për formularin

Kujdes nga mashtrimet që kërkojnë para, ja si të kuptoni nëse është e autorizuar



mërisë. Ato mund të tentojnë t'u kërkojnë kandidatëve të paguajnë për shërbime si formulari dhe informacionet, të cilat janë falas në adresat e internetit të Departamentit të Shtetit dhe të

ambasadave. Disa shoqëri kërkojnë pagesa për të plotësuar formularin e aplikimit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojshme. Nuk ka asnjë pagesë për të plotësuar formularin e aplikimit elektronik për Vizën e Shumëllojshme. Fituesit do të njoftohen vetëm nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit duke filluar nga data 2 maj 2017, në faqen e Internetit të Departamentit Amerikan të Shtetit, Byrosë së Çështjeve Konsullore, dhe nuk është e nevojshme përdorimi i ndihmësve për të aplikuar për Vizën e Lotarisë. Vetëm aplikantët e përzgjedhur njoftohen nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK). Asnjë organizatë tjetër apo kompani private nuk është e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për të njoftuar aplikantët e DV-së për përzgjedhjen e aplikimit të tyre si fitues, apo të hapave të mëtejshëm në procesimin e aplikimit për vizë.

← bashkohen me aplikantët, do të rezultojë në refuzimin e aplikantit kryesor dhe refuzimin e të gjitha kërkesave për vizë në kohën e intervistës për vizë. Pasi kandidatit të ketë dorëzuar elektronikisht regjistrimin e plotë, do t'i shfaqet një faqe konfirmimi, e cila përmban emrin dhe numrin unik të konfirmimit. Kjo faqe duhet printuar dhe duhet ruajtur.

PËRZGJEDHJA
Departamenti i Shtetit kurë nuk do të dërgojë një email për të njoftuar aplikantët se janë përzgjedhur për programin e DV-së. Duke filluar nga 1 maji 2018, kandidatët mund të kontrollojnë statusin e regjistrimit në faqen zyrtare www.dvlottery.state.gov, duke klikuar mbi Kontrollin e Statusit të Regjistruarit dhe duke futur numrin unik të konfirmimit dhe informacionin personal. Kontrolli i Statusit të Regjistruarit do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen për Lotarinë DV-2019, duke dhënë udhëzime se si aplikantët të vazhdojnë me tej me aplikimin dhe si do të njoftohen mbi takimin për vizë emigrimi. "Nëse aplikimi juaj përzgjidhet dhe ju i përgjigjeni njoftimit të përzgjedhjes tuaj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarit, ju do të merrni email-e të tjera komunikuese nga Departamenti i Shtetit duke ju njoftuar që

informacion me detaje i intervistës për vizën emigruese është vendosur në Kontrollin e Statusit të Regjistruarve", thuhet në udhëzimin nga SHBA. Nëse kandidatit është përzgjedhur,

gjitha shqyrtimet e aplikimeve dhe lëshimi i vizave DV të aplikantëve të përzgjedhur që kanë plotësuar kërkesat e duhura edhe për anëtarët e familjes së tyre duhet të përfundojnë

FORMULARI

"Jeni të inkurajuar të plotësoni vetë formularin e regjistrimit, pa ndihmën e një 'këshilluesi për viza', 'agjenti të vizave' ose personave të tjerë që ju ofrojnë ndihmë. Nëse është dikush tjetër që ju ndihmon, duhet të jeni të pranishëm në momentin e përgatitjes së regjistrimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve në mënyrë sa më të saktë, të merrni faqen e konfirmimit dhe numrin e konfirmimit", thuhet në udhëzimet e ambasadës.

në mënyrë që të marrë një vizë DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, ai prapëseprapë duhet të përbushë të gjitha kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit të SHBA-ve. Këto kërkesa mund të rrisin nivelin e kërkuar të shqyrtimit dhe kohën e nevojshme për shqyrtim për vendasit e disa vendeve të renditura në këtë njoftim, duke përfshirë, por jo kufizuar, në vendet e përcaktuara si shtete sponsoriazuese të terrorizmit. Të

deri më 30 shtator 2019. Në asnjë rrethanë DV-të nuk mund të lëshohen apo të autorizohen pas kësaj date, dhe as anëtarët e familjes së DV-së të cilët nuk e morën vizën në të njëjtën kohë me aplikantët kryesor nuk mund t'i bashkohen aplikantit kryesor në Shtetet e Bashkuara pas kësaj date.

60 MINUTA PËR APLIKIM
Formulari i regjistrimit të E-DV-së (lotarisë elektronike) është projektuar që të

plotësohet dhe dorëzohet njëherësh. Aplikantët do të kenë gjashtëdhjetë minuta kohë që fillon me shpërkarkimin dhe plotësimin e formularit, deri në përfundimin dhe regjistrimin në adresën e internetit të E-DV-së. Nëse më shumë se gjashtëdhjetë minuta kalojnë dhe kandidati nuk e ka përfunduar dhe regjistruar formularin në mënyrë elektronike, informacioni i dhënë deri në atë moment do të fshihet. Sistemi fshin të gjitha regjistrimet e pjeshme që më vonë të mos përcaktohet aksidentalisht si dublikat apo formular. "Nëse fotografia/ (fotografitë) nuk i plotësojnë të dhënat teknike, regjistrimi juaj nuk do të pranohet nga interneti i E-DV-së, kështu që ju nuk do të merrni një njoftim konfirmues. Megjithatë, duke u nisur nga natyra e paparashikueshme e internetit, ju mund të mos e merrni menjëherë njoftimin për refuzim. Nëse ju mund të korrëni fotografi/fotografitë dhe të ridërgoni Pjesën e Parë apo të Dytë të formularit brenda 60 (gjashtëdhjetë) minutave, ju mund të jeni në gjendje që të paraqisni regjistrimin tuaj me suk-

ses. Përndryshe, do t'ju nevojitet të rifilloni procesin e regjistrimit. Ju duhet të mundoheni të paraqisni një formular aq herë sa të jetë e nevojshme deri në pranimin e plotë të formularit dhe deri në njoftimin për marrjen e konfirmimit. Njëherë që merrni njoftimin për konfirmim, regjistrimi juaj ka përfunduar dhe ju nuk duhet të plotësoni një regjistrim shtesë", thuhet në udhëzimin e Ambasadës Amerikane.

Gjithashtu bëhet me dije se të përzgjedhurit nuk përfitojnë asnjë shtyrje të lotarisë për vitin e ardhshëm, por që nuk janë pajisur me vizë deri më 30 shtator 2019 (fundi i vitit fiskal). Gjithashtu, bashkëshortët dhe fëmijët që përfitojnë nga statusi i një të regjistruarit të DV-2019 mund të pajisen me viza në kategori të DV-së vetëm nga 1 tetori 2018 deri më 30 shtator 2019. Aplikantët që aplikojnë jashtë kufijve të Amerikës do të marrin një njoftim nga Departamenti nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV-së katër deri në gjashtë javë përpara datës së takimit të planifikuar për intervistë.

TARIFAT

Nëse ju jeni një aplikues i përzgjedhur rastësisht, ju do të merrni ndihmë mbi shqyrtimin e aplikimit të vizës së DV-së nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek www.dvlottery.state.gov. Ju do të paguani të gjitha tarifën e DV-së dhe vizën së emigrimit personalisht vetëm në Ambasadën ose Konsullatën e SHBA-së në kohën e aplikimit për vizë. Arkëtarë konsullor do ju japë menjëherë një faturë të qeverisë së SHBA-së për pagesën. Mos i dërgoni para asnjëherë për tarifën e DV-së nëpërmjet postës, Western Union, ose kujtudo shërbimi tjetër dërgesash nëse ju jeni duke aplikuar për një vizë emigrimi në një Ambasadë ose Konsullatë të Shteteve të Bashkuara. Nëse ju jeni përzgjedhur dhe ndodheni tashmë në Shtet e Bashkuara, dhe planifikoni të depozitoni një kërkesë për rregullimin e statusit pranë USCIS, fleta e udhëzimeve e aksesueshme nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek www.dvlottery.state.gov përmban udhëzime të veçanta se si të dërgoni tarifën e DV-së pranë një banke amerikane. Tarifën e vizave nuk mund të rimbursohen. Ju duhet të përmbushni kualifikimet për vizë ashtu siç është specifikuar në këto udhëzime. Në rast se zyrtari konsullor vendos se ju nuk i përmbushni të gjitha kërkesat për vizë ose se ju nuk jeni i pranishëm për Vizën e Shumëllojshme, sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, oficeri nuk mund t'ju lëshojë vizë dhe do t'ju mbahen tarifën e paguara.

INFORMACIONI

"Aplikanti duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm për të plotësuar regjistrimin E-DV, ku duhet të japë: emrin, gjininë, datën e lindjes, vendin e lindjes, vendin ku jeton, adresën postare, adresën e email-it dhe fotografitë të marra brenda gjashtë muajve të fundit, të kandidatit kryesor, bashkëshortit dhe të gjithë fëmijëve."

Studio Përmbarimore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankanidën e pare për pasuritë:
a) "Njësi" me sipërfaqe 40 m², me nr. Pasurie 339-N5, Vol. 39, Fq. 21, Zona Kadastrale 8561, e ndodhur në Lagjia nr.18, Korçe, në pronësi të bashkëpronarve Spahi. Cënimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 31,360 (tridhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Euro.
b) "Apartament" me sipërfaqe 83 m², me nr. Pasurie 6/147+1-12, Vol.12, Fq.111, Zona Kadastrale 8581, e ndodhur në Rr. Deshmoret e Pojskes, Pogradec, në pronësi të bashkëpronarve Spahi. Cënimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 33,864 (tridhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e kater) Euro. Ankanidi i pare zhvillohet me date 04.10.2017, ora 16.00 në ambientet e Studios Përmbarimore Shkrela me Adresë:Rruga Blv. Zogu i Pall., Pall. "Agimi", H.2, K.3, Ap. 5, Tirane.

NUOFTIM
Pranë zyrës përmbarimore të shoq. "tebest" shpk, adresa Rr. "D.Hoxha" nr.915, Tirane, zhvillohet ankanidi i hapur me datën 11/10/2017, ora 15:30. Pasuritë në shitje janë: 11 Psa. Ismail me nr.7016, 2h, 1042-S-5447m2 Nr.regj.vol.11,qj.24, 144,dhe pas. nr.7042K, 1042-S-728m2 Nr.regj.vol.11,qj.24, 2h, 1042-S-5447m2, me adresë:Rruga Armanes, Krujë vlera 45083000.
Te interesuarit le paraqiten në adresën: Rr. "D.Hoxha" nr.915,Tirane. Tel.67830849; email:tebest@gmail.com

SHFAQJA

PREMIERË BOTËRORE NË TIRANË

Angjelin Preljocaj: Shqipëria si shtëpi dhe baleti natyrë-mort

Fatmira Nikolli

Me një shqipe të ruajtur prej herët, mes dialektit gegë e fjalëve frëngjisht, mjeshtri i baletit bashkëkohor, franko-shqiptari Angjelin Preljocaj foli për premierën e tij botërore, që e nis turin nga Tirana: "Trait d'Union & Création". "Sa herë vij këtu jam si në shtëpi, por si Shqipëria si Franca më kanë dhuruar shumë. Për këtë ndjehem sikur të kisha dy burime brenda shpirtit, secili kërkon dhe gjen rrugën për t'u shprehur brenda meje. Kur kthehem këtu jam shumë i gëzuar, sepse është diçka e rrenjosur, edhe është shumë e vërtetë. Jo më kot e kam zgjedhur këtë pjesë. Baleti flet për kohën që kalon, për jetën vdekjen dhe pasionin". Me një karrierë të çmuar ndërkombëtare, koreografi me origjinë shqiptare e nis nga kryeqyteti shqiptar udhëtimin e premierës së veprës së tij më të fundit me titull "Still-life" ("Natyrë e qetë"). "Jam shumë i prekur, që krijimin tim të ri, të cilin vetëm një javë më parë balerinët e interpretuan në studion ku unë krijoj çdo ditë, vjen në Tiranë. Titulli, mund të them se është një lojë fjalësh, një 'natyrë mort', por që brenda saj zhvillohet edhe jeta. Ideja e tij është të tregojë se sa i vogël është njeriu, sa e vogël është jeta tij brenda asaj të madhes, brenda universit. Baleti flet për kohën që lëmë pas, për pasionin, jetën, vdekjen, por edhe për kotësinë, një nga karakteristikat e njeriut postmodern". Nga Pallati i Kongreseve, në një bashkëbisedim krejt miqësor me gazetaret koreografi i "Preljocaj Balet", kompanisë së krijuar nga ai dhe e njohur ndërkombëtarisht, tregon se në trupin e tij ka tashmë edhe një shqiptar tjetër, Redi Shtyllën. "E zgjodha se m'u duk një kërcimtar shumë i madh mbi të gjitha, edhe pastaj kur e pashë që ishte edhe sh-



Në foto:
Posteri i
premierës
së Angjelin
Preljocaj

Premiera Botërore
TRAIT D'UNION & CREATION 2017
Balet nga Angjelin Preljocaj
4 Tetor 2017 - ora 20:00 - Pallati i Kongreseve
Tiranë

"Është një balet,
që flet për kohën
që kalon, jetën,
vdekjen dhe
pasionin"

1989, kështu që është diçka e vjetër. Krejt e kundërta e 'Dasmës' që ju e kenë në repertorin e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit. Vijnë këtu me një krijim shumë të ri. Edhe unë jam shumë lumtur edhe i prekur, që hera e parë që do të shfaqet ky krijim jashtë pavionit të zi, vendi im i krijimit, është pikërisht në Shqipëri. Baleti titullohet 'Still life' edhe zgjat 50 min. Në anglisht 'Still life' do të thotë një tablo e natyrës së vdekur, natyrës së qetë. Por më pëlqen loja e fjalëve që kemi të bëjmë me kërcimtarë që lëvizin edhe i japin jetë skenës, prandaj e quajta 'Still life', që është fjala jetë brenda". I pyetur për baletin e ardhur nga 1989-a, ai tha se "ky balet më ka pëlqyer dhe e kam dashur shumë, prandaj kam dashur që të vazhdojë që të jetojë dhe të përcjellë edhe të gjeneratat e reja atë emocion që ndiej unë brenda nëpërmjet këtij baleti. Prandaj e kam rishfaqur disa herë. Pra është një balet që e kam në kundërpeshë me baletin 'Dasma', me muzikën e Stravinskijit". Ajo çfarë ka dashur të përcjellë nëpërmjet lëvizjeve edhe jetës në skenë është vaniteti që ne kemi. "Është një balet, që flet për kohën që kalon, jetën, vdekjen dhe pasionin".

qiptar: Thashë që duhet ta marr patjetër (qesh)". Shfaqja vjen me ndihmën e Ambasadës së Francës dhe Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë sot më 4 tetor 2017 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë.

PROGRAMI

Premiera ndërkombëtare e krijimit të tij të re që deri dje mbahej "sekret", shoqërohet nga rimarrja e duo-s mashkullore të vitit 1989 "Un trait d'Union", një kërcim trup me trup "poetik dhe pasionant" i shkruar mbi muzikën koncertore të J.S. Bach dhe i interpretuar nga Glenn Gloud. Koreografi zbulon se pjesa e parë e programit është me dy kërcimtarë. "Është një balet i krijuar në vitin



This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDER | ISD | Centre for Common Ground | Terre des hommes

CALL FOR PROPOSALS ANNOUNCEMENT

Terre des hommes (Tdh) in partnership with Institute for Strategic Dialogue (ISD), Center for Common Ground (CCG) and Beder University is implementing the project "Strengthening Civil Society to build youth resilience to Violent Extremism", funded by the European Union.

The initiative aims to contribute to ensuring the active participation of civil society in preventing/countering violent extremism through building youth resilience by empowering CSO's working with young people and communities. In this framework a Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is effective **28th September 2017-30th October 2017**.

The overall amount made available under this Call for Proposals is **EUR 201,000**. Tsh Albania aims to award around 25 projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

1st category: - **5,000 EURO** (up to 5 projects)
2nd category: **5001-7,500 EURO** (up to 10 projects)
3rd category: **7,501-10,000 EURO** (up to 10 projects)

The deadline for the submission of applications is **30 October 2017 at 17:00**. The application package and related information must be found to the following links: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania>
www.cildhub.org

A copy of the Guidelines and Application package can be additionally requested through sending an email at: info@tdhalbania.org

This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDER | ISD | Centre for Common Ground | Terre des hommes

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME

Terre des hommes (Tdh) në partneritet me Institutin për Dialog Strategjik (ISD), Qendrën për Baza të Përbashkëta (CCG) dhe Universitetin Beder, po zbaton projektin "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Ngritjen e Reziliencës Rinore ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian.

Kjo iniciativë synon të kontribuojë në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet ngritjes së reziliencës rinore duke fuqizuar organizatat të cilat punojnë me të rinjtë dhe komunitetin. Në këtë kuadër, Terre des Hommes në Shqipëri, hap një Thirrje për Projekt Propozime nëpërmjet skemës së Sub-Grantimit. Kjo Thirrje për Projekt Propozime do të qëndrojë e hapur gjatë periudhës **29 Shtator - 30 Tetor 2017**.

Totali i shumës për t'u kontraktuar nën këtë Thirrje për Projekt Propozime është **201,000 EURO**

Tdh Albania synon të kontrakttojë rreth 25 projekte, të cilat ndahen sipas kategorive të mëposhtme:

Kategoria e parë: - **5,000 EURO** (deri në 5 projekte)
Kategoria e dytë: **5001- 7,500 EURO** (deri në 10 projekte)
Kategoria e tretë: **7,501-10,000 EURO** (deri në 10 projekte)

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është **30 Tetor 2017, ora 17:00**.

Dokumentat e aplikimit dhe informacionin më të detajuar për mënyrën e aplikimit mund të gjeni në adresat e mëposhtme: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania>
www.cildhub.org

Një kopje e udhëzimit për Projekt Propozime dhe dokumentat e aplikimit mund të kërkohen edhe duke dërguar një e-mail në adresën: info@tdhalbania.org

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 4 Tetor 2017 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Presidenti Ilir Meta shkon në fermën e ish-deputetit të PD-së
- Jozefina Topalli shijon Shirokën në shoqërinë e miqve të saj
- Nora Malaj ia merr valles në emisionin e gatimit
- Nominimi, Mogherini një nga kandidatet e mundshme për fitimin e çmimit Nobel për Paqen

Provokon Marina Fara. Fotot sensuale të modeles



Ariena Ara nxjerr të pasmet në koncert



Xhensila Pere:

Rrëfëhet
bukuroshja:
Së shpejti
do të vij
me një
set hot



**S'kam kohë për një partner,
meshkujt bëjnë detyrën**

"Eksperiencën time në 'DWM' dhe marrëdhënia që kam me Trimin"

Intervista

Rrëfëhet bukuroshja: Së shpejti do të vij me një set hot

Xhensila Pere:

S'kam kohë për një partner, meshkujt bëjnë detyrën

"Eksperiencia ime në 'DWM' dhe marrëdhënia që kam me Trimin"



Egla Xhemali

Bukuroshja nga Pogradeci u bë e famshme në "Big Brother", por duket se që pas asaj dite, ajo është dashuruar me ekranin. Këtë vit, Xhensila Pere po tenton me vallëzimin, duke qenë një nga konkurrentet e "Dance With Me". Edhe pse vallëzon me Trimin, ish-missit tregon se mes tyre ka gjithçka përveç flirtit. Si një vajzë beqare që është, Xhensila tregon se edhe meshkujt VIP e tentojnë me të, edhe pse nuk ia dalin.

Rikthehet në ekran Xhensila, si ju erdhi ftesa për të qenë pjesë e "Dance With Me"?

Nuk ka qenë e vështirë për produksionin që të kuptonin sa e doja këtë spektakël, pasi në çdo intervistë timen e kam shprehur dëshirën për të qenë pjesë e një spektakli vallëzimi.

A menduat t'i thoshit 'jo' kësaj ftese?

Asnjëherë! Mezi e kam pritur.

Si i kishit marrëdhëniet me kërcimin para se të bëheshit pjesë e spektaklit?

Pasioni im për kërcimin është shfaqur kudo, sidomos në "Big Brother", që mezi prisja "Happy hour" që të kërcëja.

Po konkurrentët e tjerë si i ke parë, kë sheh si më të fortin, po më të dobëtin?

Kasti është i larmishëm, ka fusha të ndryshme dhe shumë i bukur. Vetë formula e "Dance With Me" nuk të lë vend për të parë konkurrentët si më të fortë, apo më të dobët. Aty ka vetëm një rregull: kërcë! Konkurrente të fortë shoh veten, sepse jam çdo ditë në luftë me të, për të arritur maksimumin



në teknikë.

Si i ke marrëdhëniet me partnerin në skenë, a ka një flirt mes jush?

Jemi si Tommy & Jerry. Ekziston gjithçka përveç flirtit.

Përse keni munguar për kaq kohë në ekran?

Munguar?! Si gjithë të tjerët, shijova pushimet verore mbas edicionit të 3-të të "Miss Universe Albania", ku jam pjesë e produksionit dhe kemi qenë për 8 javë rresht në transmetim tek "Vizion Plus". Dhe për më tepër, më duhej ky pushim për të marrë energjitë e duhura për tek "DWM".

A është ky momenti për rikthim në TV?

Pse jo? Unë e dashuroj ekranin, besoj edhe ai mua.

Çfarë do të bëni pas kësaj, keni marrë oferta për të qenë në ndonjë format?

Është pak herët për të folur për formate të tjerë, por besoj se nuk do i ndahem më ekranit.

Duket se famën e "Big Brother" e keni lënë pas, por si ia keni dalë që të jeni ende një emër i lakuar?

Gjithçka me punë dhe përkushtim ndaj ëndrrës sime për të qenë pjesë e botës së bukur të televizionit. Gjithashtu, edhe duke rrezikuar, duke ecur jo sipas tregut, por sipas ideve të mia.

Sa ju ka ndihmuar të qenurit seksi?

Do të tregohesha hipokrite nëse do të thosha të kundërtën, që nuk më ka ndihmuar, por është thjesht 1/100 e asaj që të duhet për të ecur para dhe për të qenë ende pjesë e TV.

Duket se nuk kurseheni kur

bëhet fjalë për poza hot, kur do ta shikojmë setin e ardhshëm?

Shumë shpejt, është në "furrë, po piqet".

Me çfarë jeni marrë gjithë këtë kohë?

Kemi filluar përgatitjet me vajzën që do na përfaqësojë në "Miss Universe" në Las Vegas në datën 29 nëntor. Gjithashtu vijoj të jem pjesë e marketingut në revistën "VIP Albania".

Po jeta sentimentale si po ecën?

Kam rënë në dashuri... me kërcimin.

A keni një partner në krah?

Nuk kam kohë për partner. Plane për fejesë apo për martesë?

Pak herët, jam e vogël akoma ose të paktën kështu ndjehem.

Sa të ngacmojnë meshkujt e famshëm, ndonjë emër?

Meshkujt bëjnë detyrën, hedhin gëpin, por pastaj ngelet për t'u parë nëse arrijnë të peshkojnë. Emër?! Besoj se fola tepër.



PROVOKON MARINA FARA Fotot sensuale të modeles



E dhe pse temperaturat janë e ulur, Marina nuk ka ndërmend të vishet. Vjeshta vjen akoma më e nxehtë se vera për të dhe këtë e vërtetojnë fare qartë postimet e saj të fundit. Fotot provokuese, por edhe postimet në "Instastory" e bëjnë atë edhe më joshëse. Vajza e Eli Farës, Marina, mesa duket nuk ka ndërmend të ndalet. Fotografia dhe modelingu janë një "hobi" i parapëlqyer i bukurshes, e cila nuk harron të postojë herë pas here në faqen e saj në "Instagram" fotoshooting duke reklamuar edhe veshjet më "in" të momentit. Pas setit të fotove hot të verës, tani Marina ka filluar të postojë pjesë nga fotoshooting i saj i fundit. Ajo që e bën akoma më shpërthyesë është postimi i fundit, ku ajo shfaqet gjysmë nudo mbi një makinë, e veshur vetëm me një xhakëtë të bardhë me mbishkrimin "Shooting". Të shohim çfarë ka në mendje këtë radhë bukurshja brune.



Mbesa e ish-presidentit Bujar Nishani, Beniada Nishani, nuk ndalet së publikuari foto nudo në rrjete sociale. Më të fundit që ajo i ka publikuar në "Instastory" e tregojnë Beniaden topless dhe më sensuale se kurrë. Jemi mësuar tashmë me pozat që modelja na servir herë pas here, ndaj edhe ky set vërteton edhe njëherë se Beniada s'ka ndërmend të ndalet.

Padyshim që është një talent, e cila me muzikën e ajo ka kaluar kufijtë e Shqipërisë. E bukur dhe me një zë për t'u pasur zili, Arilena Ara ka mundur të arrijë suksesin në muzikë dhe t'i mahnitë të gjithë me zërin e saj. Këngëtarja bukurshë nuk ka qenë asnjëherë ekstravagante, por në koncertin e fundit ajo ka habitur fansat e saj. Arilena ka performuar me një veshje mjaft ekstravagante. Këngëtarja e super hitit "Nëntori" duket se ka magjepsur publikun, i cili ka brohoritur një zëri kur ajo është kthyer me kurriz dhe ka treguar veshjen e saj.



Arilena Ara nxjerr
të PASMET në koncert

Mbesa e Nishanit s'ka
ndërmend të ndalet
MODELJA POSTON
FOTO TOPLESS

BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Nominimi, Mogherini një nga kandidatet e mundshme për fitimin e çmimit Nobel për Paqen

Italia Federika Mogherini, Komisioneria e Lartë e Bashkimit Europian për Politikën e Jashtme e Sigurinë është një nga kandidatet e mundshme për fitimin sivjet të çmimit Nobel për Paqen. Komiteti i Nobelit ka seleksionuar për këtë çmim 318 kandidatë, mes të cilëve 103 janë institucione, e shefja e diplomacisë europiane kuotohet si një nga kandidatet më të favorizuara për këtë çmim të lartë, së bashku me ish-Sekretarin Amerikan të Shtetit, John Kerry e ministrin e Jashtëm të Iranit, Javad Zarif. Këta 3 personalitete të larta politike kanë luajtur një rol kyç në nënshkrimin përfundimtar të marrëveshjes bërthamore të 2015-ës mes Iranit e komunitetit ndërkombëtar. Ceremonia e dorëzimit të çmimit Nobel për Paqen pritet të zhvillohet më datë 6 tetor në Oslo.



Presidenti Ilir Meta shkon në fermën e ish-deputetit të PD-së

Presidenti Ilir Meta ka zgjedhur të qetësohet paksa, duke shijuar prodhimet bio të fermës së ish-deputetit demokrat, Rexhep Uka. Tashmë të gjithë e dinë që ai që prej vitit që u shkëput nga politika është pozicionuar në profesionin e tij dhe së bashku me familjarët ka hapur një aktivitet privat. Duket se Presidenti Meta i është përgjigjur ndoshta ftesës, por edhe kërshërisë së tij për të parë këtë investim. Së bashku me një gotë verë, Meta e Uka kanë pozuar së bashku e kjo foto shoqërohet edhe me fjalët: "Sot te ferma 'Uka', një mrekulli shqiptare. Gjithçka Bio! Me profesor Rexhep Ukën gjithmonë mëson diçka të re".

Nora Malaj ia merr valles në emisionin e gatimit

Nora Malaj, deputetja e LSI-së, ishte e ftuar në emisionin "Kush vjen për drekë". Përveç moderatores, ishte i ftuar edhe aktori i humorit Gentian Hazizi, ku mes dialogut dhe shumë të qeshurave gatuan pjatat e tyre të preferuara, ku Nora gatoi makarona me kima, një pjatë të lehtë siç e cilësoi ajo, pjatë që gahet shumë lehtë dhe shpejt. Nora së bashku me Gentin dhe me Ariolen kërcyen një valle tradicionale të Tropojës gjatë fillimit të emisionit, duke ngrohur kështu atmosferën. Vallën e kryesoi zonja Malaj dhe nga ana e saj nuk munguan as batutat: "Vallën e marrin politikanët në fillim, pastaj vazhdon populli". Dhe ndërkohë kur vallja u kthye në prapaktim, Nora shtoi me humor për Gentin: "Tani e merr ti, kjo është politika, t'i japësh shans secilit, një shans për të gjithë", duke kujtuar kështu edhe sloganin e partisë së saj gjatë fushatës.



Jozefina Topalli shijon Shirokën në shoqërinë e miqve të saj

Ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, nuk lë rast pa e shijuar vendlindjen e saj në çdo cep, sa herë i jepet mundësia. E meqenëse tashmë koha për të është më e madhe, e shohim shpesh në foto me miq e familjarë, duke vizituar pjesët më të bukura të qytetit të Shkodrës. Kështu dje, ajo postoi në rrjetin social foto me bashkëshortin e saj në Shirokë, por edhe me një prej mikeve të saj të hershme shkodrane. Duket që Topalli po i shijon këto ditë, edhe pse nuk lë jashtë vëmendjes zhvillimet politike.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikat e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së parë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikat që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtitimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistrin janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfillojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullait. Kompensimi për ish-pronarët për tokën trull, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E PARË)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Can	Lika	Abdullah	Lika	S1=16 dy are S2=9 dy livadhe	Fshati Shirq,Dajc / 3378	288	16000	16000	Pa VFJ
Adem	Çovani	Trashegimtare	Çovani	S1=100 dy are S2=8 dy pyll	Fshati Myselim / 2749	289	18000	18000	Pa VFJ
Asim	Kopliku	Arben	Kopliku	S1= 33 dy are S2=50 dy pyll S3 = 15 dy livadhe	Fshati Oblike/ 2817	270	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Avdi	Shllaku	Avdi	Shllaku	S1=95 dy are S2=90 rrenje ullinj S3=10 dy livadhe S4=200 dy kullote S5=5 dy vreshe S6= 10 dy pemishte	Fshati Vukatane / 3838	271	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Loro	Nikolla	Loro	Nikolla	e papercaktuar		272	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Prek	Cakaj	Prek	Cakaj	e papercaktuar		273	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Sulejman	Rraboshta	Selim	Rraboshta	6000 m ² livadhe	Fshati Berdice / 1159	274	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Ferdinand	Çoba	Rozi	Çoba	S1=22000 m ² are S2 15000 m ² livadhe 7000 m ² ullishte	Fshati Bardhaj / 1105 Fshati Beerdice 1157	275	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Ahmet	Llazani	Gazmend	Llazani	9000 m ² are	Fshati Dobrac / 1495 Fshati Vukatane /3838	276	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ
Ndoc	Mhilli	Ndoc	Mhilli	e papercaktuar		299	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni V. Negativ

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Jonuz	Jupi	Jup	Shima	S=45000 m2	Shkjeze / 3389	280	41600	41600	Pa VFJ Ka Vertetim pronesie
Pjeter	Mundia (Dashi)	Gjergj	Mundia	S=285000 m ² t.bujqesore	Mali i Jushit / 2566	281		153100	Ka VFJ
Pjeter	Pjetri	Anton	Lufi	S1=32000 m ² are S2= 8000 livadhe	Fshati Hajmel / 1920	282	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ Vendim Negativ
Filip		Ndoc	Kopani	S1=55000 m ² are S2= 15000 m ² livadhe S3=16000 pyll S4=15000 kullote	Fshati Plezh / 2993	283	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Pa VFJ Vendim Negativ
Kapllan,K asem	Kotri	Kapllan,K asem	Kotri	e papercaktuar		284	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Vendim Negativ
Emin	Bushati	Ahmet	Bushati	e papercaktuar		285	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Vendim Negativ
Maliq	Kraja	Flamur	Kraja	e papercaktuar		286	Vendim negativ		Mungese dokumentacioni Vendim Negativ
Lazer	Bushati	Lazer	Bushati	9 000 m ² t.bujqesore	Fshati Juban / 2008	287	Vendim negativ		Pa VFJ
Berhan	Bekteshi	trashegimtare	Bekteshi	S1=29000 m ² S2=27000 m ² t.bujqesore	Berdice / 1157	290		56500	Pa VFJ
Gjon	Kola	Ndue	Kola	S1=18000 m ² t.bujqesore S2=18 rrenje ullinj	Fshati Spathar / 3498	291		18000	Pa VFJ. Me vendimin 291 vec sip. 18 dy T.B., jane njohur per kompensim dhe 18 rrenje ullinj e llogaritur 1 rrenje= 3000 leke

Man	Syja(Zalli)	Gani	Zalli	S1=37000m ² are S2=2500m ² pemishte S3= 3000m ² mocale S4=3 rrenje ullinj	Fshati Golem / 1790	292	35500	31500	Ka vertetim kadastral. Nga sip. E njohur 35 500 jane zbritur 4000 m ² te perfituara me L. 7501 duke mbetur per kompensim sip. 31 500. Gjithashtu vendimi 292 ka njohur per kompensim edhe 3 rrenje ullinj.	
Fran	Vasaj	Hil	Vasaj	e papercaktuar		293			Mungese dokumentacioni Pa VFJ Vendim Negativ	
Rasim	Sokoli	Kujtim	Sokoli	S1=12000m ² are S2=1000m ² livadhe		294			Mungese dokumentacioni Pa VFJ Vendim Negativ	
Kole	Pali	Kole	Pali	e papercaktuar		295			Mungese dokumentacioni	
Sulo	Uruci	Xhemal	Uruci	43 000 m ² are	Fshati Kuc / 2302	296			Mungese dokumentacioni	
Pjeter	Jaku	Hil	Jaku	40 000 m ² are	Fshati Mushan / 2750	297			Mungese dokumentacioni	
Dul	Hysa	Fadil	Hysa	e papercaktuar		298			Mungese dokumentacioni	
Kasem	Doniku(Beqja)	Muharrem	Beqja	3600 m ² truall	Dobrac / 1495	98		3600	Ka Vertetim Kadastral Ka Skice. Eshte njohur dhe e drejta e parablerjes se objekteve te ndodhura mbi sip. E njohur me kompensim.	
Shkurt	Rrotani	Ejll	Rrotani	7000 m ² truall	Rranxa Bushat / 3205	97	7000	7000	Ka Vertetim Kadastral Ka Skice Ne dosje ndodhet edhe v. 97/1 dt. 9.9.1996 per percaktim in e mases se kompensimit te kesaj sip. Te njohur.	
Selman	Sukaj(Metij)	Sabah	Sukaj	S=35000m ² t.bujqesore	Fshati Mjede / 2702	277			Pa VFJ	
Celin	Toska	Margherita	Toska	e papercaktuar		278			Vendim negativ Mungese dokumentacioni	
Muharrem	Malja	Ragip	Malja	S= 43000m ² t.bujqesore	Fshati Mjede / 2702	273	43000	36800	Nga sip. Totale e njohur per kompensim prej 43000 m ² eshte zbritur sip. e kthyer me ligjin 7501 prej 6200 m ² , duke mbetur keshtu per kompensim sip. 36800 m ² .	
Kel	Rrotani	Loro	Rrotani	4100 m ² truall	Rranxa Bushat / 3205	99	4100	4100	Ka Vertetim Kadastral Ka Skice. Ne dosje ndodhet edhe vendimi nr.99/1, dt.9.9.1996 i ish KKKP per percaktim in e mases se kompensimit per sip. E njohur me vendimin 99.	
Inst. I Motrave Stegmatine		Paula	Pasqualini	1000m ² truall + 3680 m ² truall		8591	96	4680	880	Ka note transkripti Ka harte
Inst. I Motrave Stegmatine		Paula	Pasqualini	1426m ² truall + 2248 m ² truall		8591	96/1	3674		Ka note transkripti Ka harte
Leke	Margilaj	Lula	Margilaj	4500 m ² truall			95		4500	Ka VFJ Ka harte
Ndoc	Rrotaj	Ndoc	Rrotaj	8350 m ² truall			94		7850	Ka Vertetim Kadastral Ka Skice 500 m ² jane njohur me parablerje
Hafiz	Bushati	Hadi	Bushati	26000 m ² truall			93			Ka Vertetim Kadastral Ka Skice Siperfaqe t prej 1300 m ² ,2550 m ² dhe 400 m ² jane njohur me te drejten e parablerjes.

Gjon	Tanushi	Llesh	Tasnushi	18500 m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	92	10850		Ka Vertetim Kadastral Ka Skice Sip. Prej 10750 eshte njohur me parablerj e
Pashko	Gruda	Lula	Gruda	9000m2 truall	Trush Bushat / 3652	91	9000		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet e drejta eparabler jes se objekteve mbi sip. E njohur.
Ramiz	Piranaj	Ismet	Piranaj	Shtepi pa sip. 4000m2 truall	Mushan Dajc / 2750	90	4000	4000	Ka vertetim kadastral Ka harte Ka VFJ I njihet pronesia dhe mbi nje shtepi pa siperfaqe.
Zef	Jonuzi	Dede	Jonuzi	7200m2 truall	Mali I Jushit Bushat / 2566	89	7200	5600	Ka vertetim kadastral Ka harte Sip. 1600 m ² I njihet me parablerj e
Prek	Jonuzi	Luigj	Nika(Jonu zi)	10000m2 truall	Mali I Jushit Bushat / 2566	88	10500		Ka vertetim kadastral Ka harte
Asllan	Cufi	Vehbi	Cufi	3750m2 truall	Rrethina Dobrac / 1495	87	3750		Ka vertetim kadastral Ka harte
Haxhi	Osja	Fiqirete	Beqiri	1750 m2 truall	Rrethina Dobrac / 1495	86	1750		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet e drejta eparabler jes se objekteve mbi sip. E njohur.
Sait	Hallunaj	Xhevat	Hallunaj	15000m2 truall	Rrethina Dobrac / 1495	85	10500		Ka note transkript i Ka harte I vendimi 85 eshte ndryshuar ne vendimin e Gjykates nr.777 dt 10.07.199 9.Ky vendim nuk ndodhet ne dosje
Ndrek	Rrotaj	Mati	Rrotaj	10250m2 truall	Bushat / 1329	84	10000		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet e drejta e parablerj es
Zeqir	Sykja	Zeqir	Sykja	2300m2 truall	Postribe Ura e Shtrejte / 3043	83	2300	2300	Ka vertetim kadastral Ka harte
Prend	Tanushi	Lene	Tanushi	5000m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	82	5000		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet e drejta e parablerj es
Mark	Tanushi	Gjoke	Tanushi	14500m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	81	10450		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet e drejta e parablerj es
Zef	Tanushi	Jake	Tanushi	20800m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	80	20800		Ka vertetim kadastral Ka harte l njihet dhe e drejta e parablerj es se objekteve
Elez	Zeneli(Pre veja)	Eqerem	Zeneli(Pre veja)	550m2 truall	Berdice / 1157	79	550		Ka vertetim kadastral Ka harte Ka VFJ I njihet e drejta e parablerj es
Fran	Zefi	Mark	Zefi	10000m2 truall	Velipoje / 3734	78	7300		Ka harte Ka VFJ I eshte njohur e dr. e parablerj es. Ne dispozitiv ka gabim material eshte shenuar sip e njohur 780 m ² dhe ne killapa me germa shtatemij e e treqind.
Lazer	Corri	Lazer	Corri	10600m2 truall	Rranxa Bushat / 3205	77	10600	8460	Ka vertetim kadastral Ka harte
Pjeter	Shullani	Zef	Shullani	20000m2 truall	Rec,Velip oje / 3160	76	20000		Ka vertetim kadastral Ka harte
Hile	Rrotaj	Rrok	Rrotaj	500m2 truall	Bushat / 1329	75	500		Ka vertetim kadastral Ka harte + vertetim kryeplaku I njihet e drejta e parablerj es
Mark	Sokolaj	Pjeter	Sokolaj	3600m2 truall	Rec,Velip oje / 3160	74	3600		Ka vertetim kadastral Ka harte
Gjeke	Godia	Kole	Godia	24500m2 truall	Rec,Velip oje / 3160	73	24500		Ka vertetim kadastral Ka harte

(Vijon në numrin e nesërm)

Opinion i Ditës

Berlin, "post-truth politics" i një beteje elektorale

Dr. Monika Shoshori Stafa

(Vijon nga faqja e parë)

... se kjo kish qenë periudha më e çmendur e jetës së tij, ndërsa për shumë vite kish shërbyer me një qëndrim të paepur, si një anëtar i denjë i Parlamentit Europian në Bruksel. Rrethanat u shfaqën aq të papritura rrotull tij, ndërsa veten e kish parë nën petkun e shpëtimtarit të SPD-së, për ta çliruar atë prej një mallkimi që e kish mbajtur larg suksesit për vite me radhë. Këshilltarët e tij politikë deri tre muaj më parë ishin të sigurt kur pohonin, se ai ishte i vetmi sfidues që mund t'i jepte fund epokës 'Merkel' si kancelare e vendit, pas 12 vitesh të gjatë qeverisjeje.

Sikush do ta ndiqte atë në përballjet elektorale mes simpatizantëve, do të dallonte pranë tij një grup grarie që ishte aty për t'i shërbyer, një risi tashmë e pafshehur e gjermanit Schulz, nëse kujtojmë ndër të tjera se ai në deklaratat publike kish premtuar për një kabinet ku më shumë se gjysma të përbëhej nga gra dhe vajza. Si çdo lider karizmatik e me një pamje atipike vizionare, të paktën kështu shkruanin gazetaret deri në orët e fundit të betejës elektorale mes tij dhe Merkel, M. Schulz pat qenë rrethuar gjatë gjithë kohës prej një kori të bukur femëror në partinë të tij.

Ndoshta Schulz pat kuptuar se diçka nuk shkonte ashtu si duhej; ai duhej të ishte gjithçka, megjithëse kjo 'gjithçka' nuk ishte ajo që ndjekësit e tij do donin të ishte në të vërtetë. Stina e verës pat rezervuar një tullumbace ujtër për të, një tullumbace që u ngjiti lart, por plasi shpejt. Schulz nuk do ta donte kurrë atë lloj historie si ajo që shpërtheu në 'Twee!' pas publikimit të statusit: "Treni Schulz u nis... Ndajësia tjetër: Kancelaria". Aq i pakënaqur u duk të shfaqej atë kohë sa dhe ishte me rezultatin e votimeve kur ai u zgjodh si kreu i SPD-së. Thjesht liderit europian që i njihje mirë korridorët e Brukselit, iu duk si një rezultat komunist, i atyre kohëve që tashmë kishin shkuar.

Gjermania ka njohur një rrugëtim të harkuar trajektorësh të panumërta në aspektin politik në të gjithë historinë e saj politike. Gjatë nisjes së këtij viti, u duk se votuesit ndiheshin të lodhur prej kancelares Angela Merkel. Sondazhet treguan se mund të shënohej realisht një ndërrim pushtetesh dhe se Merkel, pas tri mandateve në detyrë mund edhe të mos ndiqte hapat e Helmut Kohl, liderit me peshë europiane, i cili qeverisi Gjermaninë për 16 vjet. Por tani çdo gjë ka ndryshuar. Vetëm disa javë pas votimeve dhe fitores së Merkel, disa eksponentë politikë brenda partisë së Schulz janë duke e rimenduar të ardhmen e partisë së tyre, edhe pa Schulz-in në krye.

Ekspertët e situatës politike në Gjermani flasin se sot RFGJ nuk është në gjendjen e saj më të mirë. Përpos një fushate zgjedhore të shurdhër dhe pa ndonjë jehonë inspiruese, me një rezultat aspak luftarak, Gjermania nuk është më një vend i qetë. Vendi duket i tra-



zuar dhe njerëzit janë të mbushur me urrejtje gjatë bisedave me ta, shkruajnë gazetaret që kanë mbuluar aktivitetet politike të të dy kampeve. Dhe kjo të bën të mendosh sipas tyre, se të dy liderët politikë të vendit, përkundrazi për-pjekjeve për t'u dalluar nga njerëzjtëri, në të vërtetë nuk janë shumë larg prej programeve të tyre politike përballë problematikave kryesore me të cilat po përballlet vendi.

Por një gjë u pa të shfaqej qartë gjatë muajve të fundit të fushatave elektorale të të dy kandidatëve. Angela Merkel, bija e një pastori dhe lindur në Gjermaninë Lindore, megjithëse u pa e lodhur prej qeverisjes në fillim të këtij viti, aty nga mesi i verës së nxehtë fitoi besimin në rritje të një shtrese tjetër të shoqërisë gjermane, kastës së lartë të saj. Çfarë kishte ndodhur? Kjo kastë e cila për gati një vit nuk kish shprehur asnjë notë pozitive dhe as negative ndaj riciklimit të mandatit të saj për herë të katërt, një ditë korriku, teksa organizohet takimi i G-8-ës e kish brohoritur kancelaren e përhumbur në atë vapë të nxehtë krejt papritur. E pazakontë për nga mënyra dhe aspak normale për nga statusi së cilës ajo i përket. Britma gëzimi u dëgjuan atë ditë nën një entuziazëm të papritur e shpërthyes, do të nënvizonin njerëzit e shtypit pranë saj. Tanimë pas korrikut, konfirmimi i rizgjedhjes së saj po merrte tone të çeliktia.

As ajo vetë nuk ishte përgatitur për këtë gjendje të re, shkruajnë zyrtarët e PR pranë saj. Shumë,

shumë mund të mendohej se betejën para mund ta fitonte duke luftuar vetëm, por jo kaq e mbështetur prej gjermanëve më të pasur e me më shumë ndikim në jetën sociale dhe politike të vendit. Kush do ta rishihte edhe njëherë videon gjatë atij minutazhi, do ta kuptonte fare mirë gjendjen e saj përmes portretit në ato momente pasigurie. Dhe në rast do t'i silllej në mendje vajza lindore, që nën ndrojtjen e një bije të thjeshtë pastori do të fshihte nën skutat e shpirtit, ambicien e madhe për pushtet. Historia e kësaj lidereje karizmatike në çast do të sendërtohej si ajo e pat jetuar.

Sigurisht, perceptimet janë vetëm ndjesi, por në çdo rast ato në masën më të madhe e portretizojnë figurën e tjetrit edhe nëpërmjet gjestikulacioneve në një takim të rastit, por edhe të rëndësishme si ky i G-8-s. Për të, më shumë se përmbajtja e këtij takimi, ishte e rëndësishme dhe tejet delikate një çast tjetër, të cilës ajo ia doli. Pas asaj turme speciale që e brohoriti, Merkel u pa të shpërdantë një buzëqeshje gjithë mirëdashje në çast. Tejt politikë, ajo u ekspozua si një qenie diku mes Gandit dhe mbretërshës angleze. Ndaj, e vetmja gjë që të vjen ndërmend dhe që asaj i mungon ende edhe në këto javë pas fitores, është gimi Nobel për Paqen. Ajo duhet ta marrë atë me patjetër. Atë ditë korriku, protestuesit pas ndërtesës ku mbahej takimi i liderëve të vendeve më të zhvilluara vazhduan gjatë gjithë ditës të ngrinin bar-

rikada zjarri drejt lartësive, por për kancelaren e cila tashmë kish fituar një betejë të vështirë, kjo tej dritareve të ndërtesës ishte më e vogla.

Pas kësaj dite dhe të tjerave që do të pasonin me radhë, brenda SPD, njerëzit filluan të mendonin se vetëm një mrekulli mund ta shpëtonte Schulz-in prej një humbjeje djintoze të një partie, që mediat do ta cilësonin maniakodepresive. Diku në një qytet të vogël gjerman me emrin Kösching, Martin Schulz ndërmori papritmas një udhëtim më shumë për t'i bindur të vetët se rruga drejt kancelarisë do të kalonte mes për mes këtij qyteti, meqë kreu i bashkisë së tij vinte nga radhët e partisë së tij. Atë kohë kryebashkiaku Andrea Ernhofer i dorëzoi Librin e Mikut socialdemokratit Martin Schulz, ndërsa një shënim me autografin e kancelarit të mëparshëm Gerhard Schröder të SPD-së, ishte firmosur diku në një prej faqeve të tij, shkruajnë reporterët.

"Kemi ndërmarrë hapin e parë drejt kancelarisë në Kösching", u dëgjua të deklaronte Schulz në fjalimin e tij në sheshin e qytetit, para 50 socialdemokratëve. Entuziazmi nuk do të zgjaste shumë. Rrugës për në kthim, në autobusin e fushatës së tij elektorale, gazetaret i bënë liderit socialdemokrat një pyetje të tmerrshme, e cila në fakt tashmë ajo është kthyer në një pyetje më se të zakonshme, si pjesë e një të vërtete tjetër gazetareske, të quajtur ndryshe 'post-truth politics': z. Schulz a mos vallë nuk janë përcaktuar tashmë fituesit?

HOROSKOPI

DASHI
Jeni duke ndjekur objektiva që ju lodhin dhe ju stresojnë. Mos vallë për hir të kësaj keni lënë mënjane dashurinë? Dëshira dhe pasioni do të bëjnë që të kërkoni mundësi për të biseduar dhe bashkëpunuar me partnerin më shumë se më parë.

DEMI
Një njeri që e vlerësoni do t'ju bëjë një kritikë. Do t'ju bëjë atë me mirëbesim dhe me shumë kujdes, por gjithsesi do t'ju hidhërojë së tepërmi! Tregohuni të arsyeshëm. Lëreni pas të shkuarën dhe jetoni përvoja të reja me entuziazëm të plotë, për të ardhmen.

BINJAKET
Është ditë e përsosur për arritje profesionale. Nëse ka pastaj një dashuri të re që po gatitet, mos humbi kohë dhe bëjeni të dituri! Mos u shqetësoni më për çështje që kanë të bëjnë me paraqitjen. Përqendrohuni në substancë, tek ekuilibri midis të qenit dhe të pasurit.

GAFORJA
Me mbështetjen e shkëlqyer të Jupiterit do të zbuloni se keni talente të pasqepitura, potencial praktik, që duhet ta shprehni dhe ta shfrytëzoni. Urani mik do t'ju hapë rrugë të ndryshme. Do të keni një rol rëndësishëm si në punë, ashtu edhe në jetën shoqërore.

LUANI
Ditën e sotme do të jeni më të ndjeshëm ndaj humorit të personave që ju rrethojnë. Zgjidhni me kujdes se me kë shoqëroheni. Do të keni mundësinë për të shprehur konkretisht altruizmin tuaj dhe të ndihmoni ata që do të kenë nevojë për ju.

VIËRQJERESHA
Shfrytëzoni çastin e mirëqenies shpirtërore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes... Ndërkaq, me Plutonin që ju del kundër, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë, por do t'ia dlini.

PESHORJA
Në qoftë disa kërkesa për pushtet nuk funksionojnë. Hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim, duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

AKREPI
Gjëra të reja të vogla dhe gëzime të vogla ju presin dhe do të ishte më mirë të fillonit të mësonit të përfitonin nga këto. Ndërgjegjësimi për atë që është me të vërtetë e rëndësishme do t'ju ndihmojë të kaloni disa zënka me personin e dashur.

SHIGJETARI
Nëse në jetën e një çifti xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtimit. Planetët nuk janë shumë të favorshëm ndaj jush. Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

BRICJAPI
Gaboni me kokëfortësi për mbrojtur qetësinë tuaj, por partneri duke e kuptuar, do t'ju lajë. Me pak fjalë, do të jeni edhe më të bashkuar se më parë. Mos jini koprac kur vjen puna për të treguar dashurinë, njerëzit që ju rrinë në krah e meritojnë plotësisht.

UJORI
Do të shtyni në një datë të pacaktuar një takim që nuk doni ta bëni. Pse humbni kohë me atë që e dini që në fillim se nuk është e përshatshme për ju? Mërkuri, Marsi dhe Venusi nuk shkojnë mirë, prandaj edhe ju duhet të kontrolloni nervozizmin.

PESHQIT
Saturni vazhdon t'ju mbrojt dhe të përkaftë ndërmarrjet e juaja, përfitonin nga kjo. Përpunoni të ndihmoni edhe dikë që ka nevojë. Do të vazhdojë periudha e qetësisë së madhe ekonomike dhe profesionale. Përfitonin sa më mirë.

Opinion *i* Ditës

Egocentrizimi dhe akreditimi i Universitetit të Tiranës

Prof. dr. Aljula Jubani

(Vijon nga faqja e parë)

... atëherë, kohë të vështira kaluam ne si komb, duke krijuar sindromën e bjerrjes së përgjegjshmërisë dhe të ndërgjegjes personale dhe profesionale, individuale dhe institucionale. Duket se ende po në të njëjtin qerthull vërtetime, si maskota të nuk dimë se kujt. Thyejmë njëpasnjëshëm rekordet, po tonat, të ankesave dhe të vetë-rënimit në mjerimin e mungesës së shumçkaje e mbi të gjitha të kurajës intelektuale, e cila nuk mund t'i dorëzohet arsyes së një kohe, si ajo që përshkruante At Anton Harapi "në të cillen "të ndershmë", kërkojshin me u strukë, me e 'ruejt vetin' për një kohë tjetër më të mirë"...

Duket sikur kjo kohë, në Shqipëri, ka kaluar në pankroni, për fat të keq. Kështu, veç gjithë çudirave që nuk na habisin më, edhe Universiteti i Tiranës e gjen veten viktimë të vetvetes dhe të politikave të gabuara ndaj tij.

Prej disa kohësh na vjen vërdallë makthi i një akreditimi të munguar, të pjesshëm, afatshkurtër e nuk dimë sa epitete ka parë t'i bashkëngjiten ky akreditim.

Po pse gjithë ky mister?! Profesorët dhe studentët e marrin informacionin nga gazeta e profile rrjetesh sociale. Për herë të parë nuk na është përcjellë asnjë shpresë zyrtare, asnjë kopje e raportit në rrugë institucionale. Ndërkohë që profesorati i UT-së ka qenë zëri më i fuqishëm e vlerësuesi më i qartë, më i qëndrueshëm dhe më këmbëngulës edhe për çdo udhëzim, projektvendim e deri në projektligje apo reforma të arsimit të lartë. Dhe zëri i Universitetit të Tiranës ka dëshmuar në çdo kohë fuqinë e tij, si institucioni që përfaqëson dhe frymëzon mendimin e lirë e të qytetëruar.

Por çfarë ka ndodhur ndërkohë? "Kodi i heshtjes" ka ngërthyer kësaj radhe edhe Universitetin e Tiranës. Pasiguria na shoqëron edhe pse të rinjtë e familjet e tyre na dëshmojnë çdo ditë e më shumë besimin të ne, duke zgjedhur të parin Universitetin e Tiranës.

Universiteti prej të cilit janë diplomuar pjesa më e madhe e politikaneve, ligjvënësve, shkencëtarëve, studiuesve, mësuesve, mjekëve, infermierëve në Shqipëri; sot ka një diplomë që sipas "raportit" nuk vlen në tregun e punës. Mos ndoshta të gjithë ne duhet t'i hedhim diplomatat?! Atëherë, ndoshta, edhe një pjesë e anëtarëve të Bordit të Akreditimit (dise, madje, anëtarë të komisionit të reformës) duhet të bëjnë të njëjtën gjë.

Në një vend si ky yni, raportit i studentëve me popullsinë shkon rreth 58 studentë për 1000 banorë, po të kemi parasysh. Gjithkush nga aktorët ka kontributin e vet që

arsimi i lartë të bëhet konkurrues dhe më i vlerë, për të ofruar më të mirën për të rinjtë shqiptarë. Por rezultati i këtij akreditimi do të duhej të shqetësonte secilin prej atyre që e sotmja i gjen të angazhuar në institucione të arsimit të lartë, pavarësisht profilit. Edhe pse politikë shtetërore kanë bërë që investimet në vite për student,

qet e Shqipërisë, për të konfirmuar përshtypjen intuitive, se përqindja më lartë e mësuesve të punësuar vijjnë pikërisht nga Universiteti i Tiranës, mbi 70% e atyre që zotërojnë diplomë universitare. Po e njëjta gjë konfirmohet edhe nga të dhëna të administratës publike, mbi 90% e gjyqtarëve janë të diplomuar në UT. Kjo konfirmohet edhe

lomaninë, ne që koha na solli të jemi në këtë moment në UT?! Do të duhej ta kishim kryer e, madje, me shumë përgjegjshmëri ndaj universitetit 60-vjeçar dhe mijëra të rinjve 18-vjeçarë që u besojnë të ardhmen e tyre auditorëve tanë.

Universiteti i Tiranës ka mangësi të shumta, që lidhen me politikën e gabuara shtetërore, me adminis-

tarit? Përndryshe do të vijë dita e vetasgjësimin.

Dhe, natyrisht që profesorati e studentët UT-së nuk do të pranojnë që në diplomë të shkruhet: "Akredituar vetëm për 1 vit!". Asambleja e pedagogëve, këshillat studentorë, Senati i UT-së duhet të mbledhet me urgjencë e të flasë me një zë të vetëm e të fuqishëm,



në arsimin e lartë, të jenë dhjetëra herë më të ulëta në krahasim me mesataren e vendeve të OCDE-së dhe të BE-së, shumë prej nesh, të diplomuarve në UT, kjo diplomë na ka mundësuar doktorimin në universitete nga më prestigjiozet të Italisë, Gjermanisë, Francës, Finlandës, Norvegjisë, Amerikës etj.

Por, si mund të zhvlerësohet diploma e Universitetit të Tiranës, kur në provimet e shtetit për profesionet e rregulluara kemi gjithmonë rezultatet më të larta të suksesit?!

Mjafton të interesohesh në qar-

nga të dhëna të institucioneve dhe ndërmarrjeve private.

E vërtetë se UT mund të mos ketë regjistra të rregullt me të dhëna të natyrës së mësipërme, por cili universitet mund të dëshmojë më shumë, sa kohë që edhe stafet e tyre akademike, veçanërisht profesorati me tituj shkencorë është diplomuar, ka doktoruar apo fituar tituj, në pjesën më të madhe, pikërisht në UT.

Dhe nuk do të duhej shumë për t'i identifikuar e për t'i pasqyruar këto të dhëna. Po a arritëm ta bënim këtë, duke tejkaluar mega-

trimin shpesh feudal të burimeve të tij njerëzore e financiare, me mungesa platformash e strategjish, nga të cilat vuan e gjithë Shqipëria e pasdiktaturës komuniste dhe e neodiktaturës së reformave pa vizion. E megjithatë, Universiteti ynë nuk mund të jetë kurrsesi i fundit në ranking, pas këtij të ashtuquajturit akreditim institucional, derisa ka mbështetur me stafe, kurrikula, programe e shumçkaje tjetër çdo IAL të ngritur në Shqipëri. A do të shpëtojme ndonjëherë nga psikoza e diktaturës për asgjësimin e kundërs-

sepe autoritetet akademike janë votuar dhe mandatuar për të mbrojtur interesat e universitetit tonë, interesat e studentëve tanë. Çdo emër i veçantë është i pallogaritshëm!

Sepse ne jemi universiteti që synon atë që synojnë të rinjtë, duke shkuar gjithnjë përtej vetes. Këtë e ka treguar historia e këtij universiteti. E sotmja e konfirmon. Siç thoshte Shën Agostini: "Sa herë njerëzit ankohen se jetojnë kohë të këqija, mjafton të zgjedhin të jetojnë në ndershmëri dhe kohët bëhen të mira!".

Këshilla

Gjithçka që nuk dinit për sëmundjen e yndyrnave

Mes armiqve të arterieve, veçojmë atë që drejton diabetin: kolesterolin. Çdokush që nuk e ka idenë për ekzistencën e tij, le të lexojë 6 pyetje të thjeshta e praktike rreth tij.

Çfarë është kolesterolli dhe si ta luftojmë?

I domosdoshëm për funksionimin e trupit. Kolesterolli është yndyrë që prodhohet nga dy të tretat e mëlçisë dhe nga ushqyerja. Ai është i pranishëm në sipërfaqen e brendshme të qelizave duke iu dhënë atyre fleksibilitet dhe fuqi, ndërsa i siguron në të njëjtën kohë mbrojtjen nga agjentët e jashtëm veprues. **Për të arritur tek organet e ndryshme kolesterolli përdor transportues që e lejojnë të qarkullojë në gjak.**

HDL (Low Density Lipoproteins), ose "kolesterolli i mirë" arrin edhe në mëlçi, ku përpunohet dhe bëhet eliminimi i tepërt i tij. LDL-të transportojnë kolesterolin nga mëlçia në drejtim të të gjitha qelizave. Kur LDL-të funksionojnë keq, ose janë mangët, niveli i kolesterolit në gjak rritet. Në këtë pikë kolesterolli akumulohet për të formuar pllaka që gradualisht bllokojnë arteriet. Kjo është arsyeja pse LDL njihet ndryshe edhe si "kolesterolli i keq".

Pse rritet kolesterolli?

Në vend të parë qëndron mënyra e keqe e të ushqyerit, ndër shkaqet e rritjes së kolesterolit. Ushqimet me yndyra të ngopura në veçanti, por edhe stresi, trashëgimia gjenetike, sëmundjet e caktuara (sëmundje të veshkave, sëmundja e tiroideve), marrja e disa barnave nxisin rritjen e kolesterolit në gjak. Përveç kësaj, ndikojnë edhe pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit, hipertensionit,



6 përgjigje për kolesterolin, çfarë është dhe si luftohet



sioni, diabeti, mbipësia, mënyra sedentare e jetesës janë të gjithë faktorët që bëjnë aleancë me kolesterolin e tepërt, duke rritur rreziqet për sëmundjet kardiovaskulare.

Teprica e kolesterolit, është e lidhur me peshën?

Kolesterolli dhe pësia mund të kenë lidhje mes tyre. Për peshën e tepërt që është depozituar kryesisht në pjesët e sipërme të trupit (qafa, supet, barku), vijnë nga pas anomali të shumta: hipertensionit, diabeti i tipit 2, rritja e triglicerideve dhe hiperkolesterolli. Një rënie në peshë, edhe

modeste, përmirëson shëndetin e njerëzve që kanë një indeks të masës trupore (BMI) më tepër se normalja.

Ushqimet me yndyrë, duhen ndaluar rreptësisht?

Për të zvogëluar kolesterolo-

lin, nuk është më një sekret, ju duhet të filloni të ndryshoni zakonet e të ushqyerit. Jo të gjitha ushqimet yndyrore duhen hequr. Kur hani, duhet t'u jepni prioritet yndyrave të pangopura në krahasim me të ngopurat.


Çfarë nënkuptohet me "yndyrna të mira"?

Ne duhet së pari të sqarojmë faktin se nuk ka në të vërtetë "yndyrna të mirë" ose "të këqija", janë sasitë e tyre, të tepërta apo të pamjaf-tueshme, të cilat mund të


çojnë në pasoja të rrezikshme për organizmin. Acidet yndyrore të pangopura, të quajtur kështu "yndyrna të mira", janë gjetur kryesisht në vajra, në vaj dhe në peshk. Dëgjojmë shpesh të flitet për Omega 3. Këto acide yndyrore të pangopura kontribuojnë në funksionimin efikas të sistemit kardiovaskular. Gjenden veçanërisht tek ushqimet (nuk prodhohen nga trupi), në veçanti tek peshqit e mëdhenj, tek vaji i kanolas, tek arrat dhe soja. Të tjera acide yndyrore të pangopura janë Omega 6, Omega 9, të dobishme. Omega gjendet veçanërisht në vajin e lulediellitit, të misrit ose sojës. Për një ushqim të mirë dhe të ekuilibruar, studiuesit rekomandojnë konsumimin e këtyre acideve yndyrore të pangopura, Omega 6 dhe Omega 3, në dietën tonë, por në sasi të ekuilibruara (shembull: raporti mes Omega 6/ Omega 3, afërsisht 5).

Cilat janë avantazhet e konsumimit të frutave dhe perimeve në një dietë anti-kolesterol?

Të varfra në yndyrna dhe kalori, frutat dhe perimet na mbushin me mikroushqyes, vitamina, minerale, oligominerale, fibra, thëlbësore për organizmin. Ato përmbajnë në veçanti antioksidantë që parandalojnë oksidimin e kolesterolit dhe evitojnë formimin e pllakave në arteriet. Të varfra në yndyrna të ngopura, frutat dhe perimet mbrojnë shëndetin kardiovaskular.



Fjalëkryqi (1)



- 41. Në krye të armatës.
- 42. Kahirë është përgjysmë.
- 44. Mbeten në kufij
- 45. Ente Lokale Has.
- 46. Janë efektet e tjera të ilaceve.
- 48. Kështu përfundon fukarai.
- 49. Qe poet i famshëm pers.
- 51. Një garë mes sipërmarrësve.
- 53. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 54. Fillojnë tatëpjetën.
- 55. Mban në kokë një tiara.

- VERTIKAL**
- 1. Ai dhe ajo.
 - 2. Në hyrje të rrethit.
 - 3. Eshhtë trofe që fitohet.
 - 5. Një derby i Madonnina-s.
 - 7. Ndreç në kufij.
 - 8. Mbyllin kënde.
 - 9. Mund të jenë gjaku dhe kuzhine.

- HORIZONTAL**
- 1. Gjysmë arkivi.
 - 4. Sikur janë në skuadër.
 - 6. Janë të drejtë në diplomatik.
 - 11. Një mund të jetë diplomatik.
 - 13. Ndërmarrje Montimi Kombëtare.
 - 16. Shkon kot në vreshtë.
 - 17. Janë gazetari si RD e ZP.
 - 21. Inicialet e Morricone-s.
 - 22. Shkroi Në kërkim të kohës së humbur.
 - 25. Pastaj në fund.
 - 26. Brody i Pianisti.
 - 27. Fillojnë një rubrikë.
 - 29. Skuadra merengue.
 - 31. Gjysma e mollës.
 - 32. Baudo anchorman.
 - 34. Eshhtë honi.
 - 35. Mbyllin shishe.
 - 36. Një dyluftim.
 - 37. Ishte lumi i harresës.
 - 39. Ishte xhelozja e Olimpik.
 - 40. Lutje pa cifte

- 10. Royh aktor
- 12. Janë klasat që nuk takohen.
- 14. Janë pasanikë.
- 15. Munë të jenë republike.
- 18. Raione Civile Durrës.
- 19. Kuron pa zë.
- 20. Diftong në teori.
- 22. Kur bie... nuk të le të shohësh.
- 23. Një personazh i Dickens.
- 24. Kompozoi Boccaccio.
- 25. Të fundit në ditar.
- 28. Studion bimët dhe lulet.
- 30. Franklin që qe këngëtare.
- 32. Kufizojnë paktet.
- 33. Qytet italian.
- 38. Nuk ka shenjtorë në desk top
- 43. Station televiziv gjerman.
- 45. Besim pa kufij.
- 46. Ajri i Londrës.
- 47. Loja me games.
- 50. Fillojnë detyrën.
- 52. Inicialt e Altman.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Jo të gjitha bëjnë mjaltë.
- 6. Janë skuadra.
- 12. Janë principe
- 14. Një pije freskuese.
- 15. Ashtu qoftë në kishë
- 16. Mund të jetë një mbrëmje letrare.
- 19. Gjysma e kishës.
- 20. Janë europianët e BE.
- 22. Diftong në teatër.
- 23. I 42 ai i Dos Passos
- 24. Inicialet e Presley.
- 25. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 26. Mbyllin fushatat.
- 27. Fillojnë një metodë.
- 29. Ende është ndryshe.
- 31. Mund të jenë 4 X 100 dhe 4 X 400.
- 33. Një gjuhë që flitet edhe në Sri Lanka.
- 34. Kshutu thirrje Marco Pantani.


VERTIKAL

- 35. Eshhtë faqe ene
 - 37. Mbeten në fund
 - 38. Fletë pa kufij
 - 40. Gjysmë gotike.
 - 41. Turner këngëtare
 - 42. Bëhet për zakon.
 - 44. Në fund të ndeshjes.
 - 46. Fillojnë natën.
 - 47. Eshhtë i parë në një zoom.
 - 48. Kush janë njerëzit që nuk pëlqehen fare.
 - 49. Nofka e Eisenhower.
- VERTIKAL**
- 1. Pret shumë fëmijë.
 - 2. Opera e Mascagni-t.
 - 3. Zyrë Informatiion Ndërkombëtare
 - 4. Tamam në fund
 - 5. Një dhjetë në vit
 - 7. Eshhtë i pashpirti.
 - 8. I bën edhe Agron Llakaj.
 - 9. Mbyll fjalinë
 - 10. Si e gjithë.
 - 11. Fillojnë tatëpjetën.
 - 12. Mund të jenë cigaresh.
 - 13. Jepet për hartim.
 - 17. Ka një prind me ngjyrë.
 - 18. Janë vendet aderuese.
 - 20. Ndërohen me zapping.
 - 21. Eshhtë nofkë
 - 23. Eshhtë "Catia e botës"
 - 25. Mund të jenë zemërkau.
 - 28. Eshhtë hidrokarbur.
 - 30. Eshhtë kreu i bandës.
 - 31. Futën në prizë.
 - 32. Eshhtë vija e portës.
 - 36. Janë llojet e njerëzve.
 - 39. Si moral
 - 40. Ka dy bigami.
 - 43. Fillojnë daljen.
 - 45. Sikur janë në krye.
 - 47. Inicialet e Klee piktor.




- 8. I bën edhe Agron Llakaj.
- 9. Mbyll fjalinë
- 10. Si e gjithë.
- 11. Fillojnë tatëpjetën.
- 12. Mund të jenë cigaresh.
- 13. Jepet për hartim.
- 17. Ka një prind me ngjyrë.
- 18. Janë vendet aderuese.
- 20. Ndërohen me zapping.
- 21. Eshhtë nofkë
- 23. Eshhtë "Catia e botës"
- 25. Mund të jenë zemërkau.
- 28. Eshhtë hidrokarbur.
- 30. Eshhtë kreu i bandës.
- 31. Futën në prizë.
- 32. Eshhtë vija e portës.
- 36. Janë llojet e njerëzve.
- 39. Si moral
- 40. Ka dy bigami.
- 43. Fillojnë daljen.
- 45. Sikur janë në krye.
- 47. Inicialet e Klee piktor.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2			8		3			
		7						2
	4				9			6
9			2			4		
			1		7			
1			6				5	
9		6			8			
7					1			
		3	4			2		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikosh me të. Eshhtë një shpërbërje, bie prapë në burimin e qënies për t'u çlodhur e për tu rinovuar. Do të thotë, të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin – dhe mund të rilindësh prapë, deri sa të bëhesh i Zgjuar.
- Nëse doni të arrini ndriçimin, nuk duhet të studioni mësimë të panumërta.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

13	5	10	1	10	19	8	5	8	6	3	19
O	13	A	T	12			3	4	18	14	
13		13	3	2	4	3	2	4	5	3	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3	18	
7	1	4	6	15	5	10	3	5	3	8	4
19	9	20	2	10	1	4	6	3	2		
1	11	6	17	2			1	10	15		
8	13	1	6	1	9		3	5	10	13	2
3	6	10	7	2		6	2	4	6	2	10
18	10		4		5	13	6	14	6		11
12	2	14	2	3		2	11	6	10	5	4
6		5	14	1	3		17	2	20	5	3

A	Z	O	V	E	T	N	A	B	A	
Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S
I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I
L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I
T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V
M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E
E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N
T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E
A	M	O	R	F	R	A	T	A	R	
L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A
E	R	I	C	C	E	V	O	N	E	
T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	F	F	I	
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I		
R	I	T	E	T	R	E	L				A	M	
A	L	E	T	F	I	L	O	K	T	E	T	I	
H	E	K	A	M	I	K	A	Z	E	K			
		P	R	O	T	O	K	O	L	L	A	R	E
K	A	T	A	M	A	R	A	N	I	O	T		
I	R	C	O	L	I	N	R	O	M	Y			
T	E	M	A	E	I	B	O	R	I	S			
A	N	I	T	A	E	M	I	L	A	N	O		
R	A	N	V	I	T	M	J	E	R	A	N		
E	T	I	L	E	N	F	R	A	T	I			

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Ehënie të mënçura

- **BUDA**
- - Uji kanalizon burimet, harkëtarët lakojnë shigjetat, marangozët përkulin drurin, të mënçurit vetëbinden.
- - Ai që vesh robën e verdhë pa u pastruar, pa fituar dominimin e vetes e pa kërkuar të vërtetën, është i padenjë për ta veshur atë.
- - Sikundër nuk ka peshk pa hala, nuk ka edhe njeri pa të meta. [Luter]
- - "Çdo dalje është një hyrje diku." Tom Stoppard
- - Mendojnë për të ardhmen me shqetësim, dhe harrojnë të tashmen, nuk e jetojnë të tashmen e as të ardhmen, (i humbin të dyja).

